



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
“Menaxhim Ekzekutiv”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Luarasi”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Ph.D Eriona SHTËMBARI

2. Dr. Enis FITA

Nëntor/ 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për programin e studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Ekzekutiv” ofruar nga
Universiteti “Luarasi”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Luarasi”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Administrim Biznesi
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Menaxhim Ekzekutiv”
4	Urdhëri/ VKM i licencimit:	UMASH Nr. 483, datë 12.10.2012
5	Urdhëri/ VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 147, datë 16.04.2021
7	Urdhëri/ VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr.432, datë 25.08.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2019 - 2020: 10 PAE / 4 PAK 2020 - 2021: 9 PAE / 5 PAK 2021 - 2022: 9 PAE / 3 PAK 2022 - 2023: 8 PAE / 5 PAK
18	Numri i studentëve:	2019 – 2020; 33 studentë 2020 – 2021; 52 studentë 2020 – 2021; 46 studentë 2022 – 2023; 50 studentë
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Menaxhim Ekzekutiv" (MSHME) është hapur në vitin 2012, konform Urdhërit Nr. 483, datë 12.10.2012, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për hapjen e disa programeve të reja të studimit të ciklit të parë dhe të dytë pranë Shkolles së Lartë Private "Luarasi", si pjesë e programeve të studimit që ofrohen nga Fakulteti Ekonomik është një nga njesitë kryesore të Universitetit "Luarasi" i cili ofron studime në dy ciklet e studimit: Bachelor dhe Master.

Depiamenti Administrim Biznesit (DAB), Fakulteti Ekonomise (FE). Programi studimit të Ciklit të dytë MSH në "Menaxhim Ekzekutiv" është program me kohë të plotë, me 120 kredite (ECTS) dhe kohezgjatje 2 vite akademike. Niveli i diplomës është në kuadrin e Komizës Shqiptare të kualifikimeve: Niveli 7.

Programi i studimit të Ciklit të dytë MSH në "Menaxhim Ekzekutiv" është akredituar në vitin 2015 me Vendim Nr. 96, datë 02.11.2015 të Keshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë bazuar në ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë". Pasuar me Urdhërin Nr. 22, datë 19.01.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit për akreditimin me kusht të Programit të studimit të Ciklit të dytë MSH në "Menaxhim Ekzekutiv", bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. Kushtet u konsideruan të plotësuara në bazë të Vendimit Nr. 184, datë 07.07.2016 të Keshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë. MSH në "Menaxhim Ekzekutiv" i cili ka vijuar me akreditimin bazuar në Urdhërin e MAS Nr.432, datë 25.08.2016.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit mbështetur ne Vendimin Nr. 96, datë, 02.11.2015

Programi i studimit të Ciklit të dytë MSH në "Menaxhim Ekzekutiv" është akredituar me kusht në vitin 2015 me Vendim Nr. 96, datë 02.11.2015 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë bazuar në ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë". Pasuar me Urdhërin Nr. 22, datë 19.01.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit për akreditimin me kusht të Programit të studimit të Ciklit të dytë MSH në "Menaxhim Ekzekutiv", bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".


KA ka dhënë vlerësim pozitiv me kushte, duke rekomanduar:

- Uljen e numrit të lendeve që ofron një pedagog i brendshëm si dhe perputhje me të mirë të fushës së tyre me lëndët që mbulojnë. Përmirësimet e këtij treguesi synonin rritjen e peshës së ngarkesës mësimore në favor të stafit efektiv.
- Zgjerimin e hapësirës dhe fondit të bibliotekës.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Shkolla e lartë Universitare Private "Luarasi" (sot Universiteti "Luarasi") i ka plotësuar kushtet e rekomanduara brenda një periudhe 9 mujore, duke ju drejtuar KAAL me raportin për plotësimin e kushteve.

Kushtet u konsideruan të plotësuara në bazë të Vendimit Nr. 184, datë 07.07.2016 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bazuar në Urdhërin e MAS Nr.432, datë 25.08.2016, Programit të studimit MSH në "Menaxhim Ekzekutiv" i ka vijuar akreditimi. (Ref. Evidenca 65 Urdher MAS Nr. 432, dt. 25.08.2016 Per Plotësimin e Kushteve per Akreditimin e Programit MSHME.)



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesë sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (ascal.al, standardet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga PhD. Eriona Shtëmbari dhe Dr. Enis Fita. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Znj. Aviola Bardhi, përfaqësues i ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetje, të cilat u realizuan gjatë vizitës në vend. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në Universitetin Luarasi që u zhvillua në datën 15 Maj 2023 sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit, intervistave, komenteve për DVV, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij për përmbushjen e rekomandimeve të nga akreditimi i parë, dhe më pas vlerësimin sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Ekzekutiv". Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analizë mbi programin e studimit që akreditohet, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të studentëve të diplomuar. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra me programin e studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Ekzekutiv" duke dhënë disa sugjerime/ rekomandime.



Më datë 12.09.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr 33/21 Prot., datë 12.09.2023 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 06.10.2023 dhe me shkresë zyrtare Nr 130/2 Prot., datë 18.09.2023, ardhur në protokollin e ASCAL më datë 09.10.2023.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft- raportin, sqaron si vijon:

Standardi II.2

GVJ vlerëson reflektimin e GVB përmes ridërgimit të tabelave të përditësuara duke pranuar gabimin njerëzor të përlogaritjes së ngarkesës PAE/ PAK për 2022-2023.

Në përfundim GVJ e pranon komentin e IAL për Stand. II.2.

Standardi II.3 dhe Standardi II.4

GVJ vlerëson reflektimin e rekomandimit për vazhdimësinë, por raporti i referohet periudhës para vitit të ri akademik 2023-2024. GVJ ka verifikuar Syllabuset e programit (Ev. 21) sipas kritereve VKM 41/2018 e ndryshuar (Shtojca nr. 2) si dhe verifikimit të PM 2022-20223 (Evidenca 61).

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.

Standardi II.6 dhe Standardi II.7

GVJ vlerëson reflektimin e rekomandimit për vazhdimësinë, por raporti i referohet përfshirjes së studentëve në projekte kërkimore (Tab. 22 – Tabelat përmbledhëse) në nivel departamenti kjo dhe për statusin e programit Master i Shkencave, pavarësisht se zyrat funksionojnë në rang institucional. GVJ vlerëson pozitivisht angazhimin për vitin e ri akademik 2023-2024.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.

Standardi III.3

GVJ vlerëson reflektimin e rekomandimit, por raporti i referohet periudhës para vitit të ri akademik 2023-2024.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.



Standardi III.4

Konkluzioni është në nivel sugjerimi për një rishikim të kurrikulës e cila nuk është rishikuar prej një dekade. GVJ mendon se ky hap është i nevojshëm për të reflektuar zhvillimet e reja teknologjike në biznes dhe për ti ofruan studentëve zhvillimin e aftësive të reja që kërkon sot tregu i punës.

E128 e referuar në RVB (dhe RVJ, kriteri 6 I ketij standarti), paraqet punime të stafit akademik. Kurse E85, E95 paraqesin certifikata pjesëmarrje në forum biznesi dhe jo punime shkencore të referuara në konferenca apo botuara në revista shkencore.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.

Standardi III.5

Komenti i GVB sqaron procesin e shpërndarjes së temave të diplomave por nuk jep evidenca të reja mbi përmbushjen e këtij standardi dhe rekomandimi të GVJ.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.

Standardi IV.1

GVJ vlerëson reflektimin e rekomandimit në vijim.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.

Standardi IV.3


GVJ vlerëson reflektimin e rekomandimit në vijim. Sugjerimi për zgjerimin e hapësirave të bibliotekës (i lënë edhe nga akreditimi i meparshëm) do ti vinte në ndihmë studentëve jo vetëm për studim individual me libra hard copy apo elektronik, por edhe punëve në grup apo përdorimit të databazës elektronike për kërkim shkencor apo detyra kursi.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.

Standardi IV.5

GVJ nuk ka evidencë të vënë në dispozicion, por vlerëson reflektimin e rekomandimit dhe zbatimin e tij në vijim me projektet e fituara.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.



Standardi VI.1

GVJ i referohet përfshijes konkrete të stafit në trajnime ku të përftojnë përmirësimin e teknikave të mësimdhënies pasi nuk ka evidenca për këtë (Ev. 81/82/100, prezantime në format PPT, nga ku nuk evidentohet përfitueshmëria; nuk ka evidencë për pjesëmarrje/reagime apo dhe certifikime lidhur me formësimin e kërkuar).

Gjithashtu, mungojnë analizat e detajuara (nuk ka evidenca) të NJSBC në nivel departamenti/program dhe pse NJSBC funksionon në nivel institucional. Gjatë vizitës dhe takimit me NJSBC, kjo pikë u mbështet dhe nga drejtuesit e zyrës.

GVJ e vlerëson reflektimin e rekomandimit të NJSBC për të rritur në vazhdimësi kuorumin e njafitueshëm në perceptimin e studentëve ndaj cilësisë si dhe mekanizmave për garantimin e saj.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.

Standardi VI.2

GVJ vlerëson angazhimin e NJSBC për të përmirësuar funksionimin e saj efektiv në të ardhmen, por nuk ka evidenca mbi monitorime të detajuara të NJSBC me gjetje apo rekomandime në nivel njësie bazë që garantojnë sigurimin e cilësisë së programit MShME.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.

Standardi VI.3

GVJ nuk ka evidenca që monitorojnë matjen si dhe rekomandimet e NJSBC për përmirësimin e cilësisë në rang departamenti apo programin e studimit MSHME. Në kriterin VI.1, GVB pranon që duhet të rritet kuorumi i përfshirjes së studentëve në pyetësorët periodikë.

Kriteret e formës së syllabusit përcaktohen në VKM 41/2018. NJSBC mund të përfshihet jo vetëm në zbatimin e tyre sipas formës, por dhe në përmbajtjen referuar tematikave dhe shpërndarjes sipas literaturës së paku e 5-së viteve të fundit.

Nuk ka evidencë të bashkëpunimit mes NJSBC dhe Zyrës së Kurikulës.

Në përfundim GVJ nuk e pranon komentin e IAL dhe Raporti nuk ndryshon.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Menaxhim Ekzekutiv”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Bazuar në Vendimin e hapjes Universiteti "Luarasi" (UL), Statutit, Rregullores kryesore, Rregulores së Programit Master i Shkencave ne Menaxhim Ekzekutiv (MSHME), UL ofron programe studimi në Ciklin e parë "të studimeve Bachelor" dhe Ciklin e dytë të studimeve Master "Shkencor" dhe Master "Profesional", të cilat janë në përputhje me interesat kombëtare duke synuar ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare si dhe përgatitjen e specialisteve të fushes së ekonomisë me njohuri, kompetenca dhe aftësi në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Programet e studimit mbështeten në misionin e UL, duke synuar t'u japë studentëve një edukim të qendrushëm; duke I shërbyer dijes së shoqërisë shqiptare duke iu përmbytur interesave kombëtare dhe duke kontribuar në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit.</p> <p><i>Evidenca 1. Vendimi për hapjen e UL</i> <i>Evidenca 2. Statuti i UL</i> <i>Evidenca 3. Rregullore e UL</i> <i>Evidenca 4. Plani Strategjik UL</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e FE</i> <i>Evidenca 6. Plani Strategjik i Zhvillimit të FE</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Masteri Shkencave në "Menaxhim Ekzekutiv" është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë së tij.</p> <p><i>Evidenca 3. Statuti i UL</i> <i>Evidenca 4. Rregullore e UL</i> <i>Evidenca 5. Plani Strategjik UL</i> <i>Evidenca 13. Propozimi për Hapje Fakulteti/Programesh</i> <i>Evidenca 14. Vendimi për 1-Iapjen e Programit MSHME</i> <i>Evidenca 7. Rregullore FE</i> <i>Evidenca 8. Plani Strategjik i Zhvillimit te FE</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së</p>	<p>Programi i studimit Masteri Shkencave në "Menaxhim Ekzekutiv" është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores se UL si dhe me fushat dhe drejtimet akademike të tij.</p> <p><i>Evidenca 3. Statuti i UL</i></p>

Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	<p><i>Evidenca 4. Rregullore e UL</i> <i>Evidenca 5. Plani Strategjik UL</i> <i>Evidenca 7. Rregullore FE</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e DAB</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Programit MSHME</i> <i>Evidenca 11. Strategjia e Zhvillimit të Programit MSHME</i> <i>Evidenca 12. Strategjia e Zhvillimit të DAB</i></p>			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	<p>Programi i studimit MSHME është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe ndërkombëtar. Në kuadër edhe të politikave kombëtare për aderimin e Republikës së Shqipërisë në organizmat ndërkombëtare si dhe përafrimit të legjislacionit me atë të vendeve të BE-së, programi i studimit ka synuar të përgatisë specialistë dhe ekspertë të kualifikuar me njohuri të thelluara në fushën e Menaxhim Ekzekutiv.</p> <p>Strategjia e zhvillimit të këtij programi studimi është hartuar dhe realizohet në përputhje me vizionin kombëtar për Arsimin e Lartë, përshkruar në Ligjin nr. 80/2015, Planin Strategjik të UL, dhe Strategjine e Zhvillimit të Departamentit të Administrim Biznesit.</p> <p><i>Evidenca 5. Plani Strategjik UL</i> <i>Evidenca 11. Strategjia e Zhvillimit të programit MSHME</i> <i>Evidenca 12. Strategjia e Zhvillimit të DAB</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit ka vite që ofrohet nga IAL, ka kaluar një proces të mëparshëm vlerësimi dhe është në përputhje të plotë me interesat kombëtare, strategjitë zhvillimore si dhe me profilin dhe dokumentat strategjitë të IAL.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>UL pas shumë vitesh veprimtarie në tregun e arsimit të lartë jopublik, dëshmon se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit MSHME, i hapur në vitin 2012. Personeli Akademik Efektiv (PAE) në njesinë bazë përbëhet nga 7 pedagogë, ku 2 janë me titull Prof. As. Dr., 2 me titull Doktor, 2 janë Doktorantë dhe 1 është MSc.</p> <p>Personeli Akademik me Kontratë (PAK) përbëhet nga: 2 Profesorë të Asociuar, 4 Lektorë me gradën Doktor, 3 Asistent-Lektorë.</p>

	<p>Sikurse vihet re (Tabela 6: "Cilësia e stafit mësimdhënës për programin"), personeli akademik është i përshtatshëm për ofrimin e programit të ciklit të dytë në Menaxhim Ekzekutiv.</p> <p>Sipas verifikimit të Tab. 7 (dok. Shtese riderguar pas vizites GJV) "Të dhëna përmbledhëse të stafit akademik për programin Msc Menaxhim Ekzekutiv, sipas kualifikimit dhe raporti mes tyre"; Planit mësimor (Evidenca 61) dhe Tabela 13 "Ngarkesa totale në auditor e studentëve", raporti i ngarkesës së stafit PAE/ PAK paraqitet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • V. 2022-2023, PAE/ PAK - 870/360 = 1230 ore, PAE = 71 %; • V. 2021-2022, PAE /PAK - 945/285 = 1230 ore, PAE = 76%; • V. 2020-2021, PAE/ PAK - 915/315 = 1230 ore, PAE = 74%; • V. 2019-2020, PAE/ PAK - 945/285 = 1230 ore, PAE = 76%; <p><i>Tabela 1. Personeli akademik në Njesine kryesore dhe Njësine bazë</i> <i>Tabela 6. Staf Akademik për programin e studimit</i> <i>Evidenca 1. Vendimi për hapjen e UL</i> <i>Evidenca 19. Certifikata e Akreditimit Institucional</i> <i>Tabela 7. Të dhëna përmbledhëse të stafit akademik për programin Msc Menaxhim Ekzekutiv, sipas kualifikimit dhe raporti mes tyre</i> <i>Tabela 13. Ngarkesa totale në auditor e studentëve</i> <i>Evidenca 63. Urdher MAS Nr. 96, dt. 02.11.2015 Per Akreditimin e Programit MSHME</i> <i>Evidenca 64. Urdher MAS Nr. 22, dt. 19.01.2016 Per Akreditimin e Programit MSHME</i> <i>Evidenca 16. Vendimi i Akreditimit UL 2017</i> <i>Evidenca 17. Vendimi i Akreditimit UL 2020</i> <i>Tabela 16. Mjediset e Fakultetit/Njesive Baze</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit MSHME është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, Fakultetit Ekonomik dhe njësisë bazë Departamentit të Administrim Biznesit (DAB), i cili është përgjegjës për programin e studimit.</p> <p>DAB është njësia bazë e FE-së, e cila e ofron programin e studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Ekzekutiv", i cili është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të FE-së. Ky program i përket Komizes Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), me numrin unik të direktivave dhe udhëzimeve të identifikimit në regjistrin e diplomave të regjistruara në Ministrinë e Arsimit në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Sipas vlerësimit të GJV procesi i kodifikimit nuk është përfunduar, por mbetet në proces.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore FE</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e DAB</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Programit MSHME</i> <i>Evidenca 8. Plani Strategjik i Zhvillimit të FE</i> <i>Evidenca 12. Strategjia e Zhvillimit të DAB</i></p>

	<p><i>Tabela 3. Te dhena tabelore per numrin e programeve</i> <i>Evidenca 30. Miratimi i Formes se Diplomes dhe Numrit Unik te Identifikimit</i> <i>Evidenca 18. Propozime mbi Kodifikimin e Programeve te Studimit</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit MSHME është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, Departamentit të Administrim Biznesit, i cili është përgjegjës për këtë program studimi.</p> <p>Ky program studimi synon t'u japë studenteve njohuri të nevojshme, në fushën e menaxhimit. Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e drejtuesit të niveleve të ndryshme në kompanitë e biznesit apo në institucionet shtetërore. Pas përfundimit të programit, falë njohurive të marra, studenti aftësohet për mundësinë e punësimit në njësitë e ndryshme ekonomike, kryesisht në nivele të menaxhimit të lartë në sektorin privat, si dhe në nivel drejtuesi në administratën publike.</p> <p><i>Tabela 3. Te dhena tabelore per numrin e programeve</i> <i>Evidenca 61. Planet Mesimore MSHME</i> <i>Evidenca 21. Programet mesimore te lendeve te programit MSHME (Syllabuset)</i> <i>Evidenca 22. Model i Suplementit le Diplomes</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	NA			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Fakulteti Ekonomik ka marrëveshje bashkëpunimi me firma në biznes dhe institucione të ndryshme ekonomiko-financiare. Ai ofron trajnime profesionale të vazhdueshme/ leksione të hapura për studentet e diplomuar (alumni) në bashkërendim me interesat e punëdhënësit.</p> <p><i>Evidenca 23. Institucionet bashkepunuese me UL</i> <i>Evidenca 25. Raporti mbi Marrëveshjet e Bashkëpunimit</i> <i>Evidenca 57. Trajnime/aktivitete</i> <i>Tabela 3. Të dhena tabelore per numrin e programeve</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin. Programi duhet të vijojë procedurën për kriterin e kodifikimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Fakulteti Ekonomik ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit. Kjo realizohet nepermjet ndarjes së detyrave mes njësive dhe personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> <p>Kjo është është e përcaktuar në rregulloren e UL si dhe në rregulloren e Fakultetit Ekonomik. Detyrat dhe përgjegjësiwe ndahen midis njësive të ndryshme kryesore apo njësive bazë përkatëse, ku pesha kryesore mbulohet nga njesia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, Departamenti i Administrim Biznes.</p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e UL</i> <i>Evidenca 7. Rregullore FE</i> <i>Evidenca 27. Struktura Organizative e UL</i> <i>Evidenca 28. Raporti Vjetor 2021-2022</i> <i>Evidenca 129. Raporti Vjetor 2019-2020</i> <i>Evidenca 130 Raporti Vjetor 2020-2021</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e DAB</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UL, Fakulteti Ekonomik i kushton vënendje bashkëpunimit me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit brenda vendit. Kjo ka si qëllim realizimin sa më të mirë dhe të plotë të objektivave të procesit mësimor dhe njohurive formues të studentëve pjesmarrës në këtë program studimi. Aktivitetet e kryera në kuadër të Marrëveshjeve të bashkëpunimit, janë të pasqyruara në analizen vjetore institucionale. Si pjesë e grupit "Hysenbelliu" dhe marrëveshjes me të, Institucioni gjithashtu mund të realizojë këto objektiva formuese edhe pranë kompanive të tjera të grupit.</p> <p>Aktivitetet e kryera në kuadër të marreveshjeve të bashkëpunimit, janë të pasqyruara edhe në analizen vjetore institucionale.</p> <p><i>Evidenca 23. Institucionet bashkëpunuese me Luarasin</i> <i>Evidenca. 25. Raporti mbi Marrëveshjet e Bashkëpunimit</i> <i>Evidenca 28. Raporti Vjetor 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave</p>	<p>Per realizimin e programit te studimit, MSHME, Fakulteti Ekonomik, ka nënshkruar marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit te personelit akademik dhe studentëve. Në vitin e dytë të studimeve, semestri i dytë realizohet praktika mësimore. Kjo praktikë realizohet në institucione të ndryshme shtetërore, por gjithashtu edhe në firma biznesi të cilat</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 13

<p>të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>mundesojnë prezencën e studentëve sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit nënshkruar me FE-në, por edhe në institucione të tjera private dhe shtetërore, ku studentët e gjejnë vendin e praktikës nepërmjet kërkimit të tyre individual ose të orientuar/ mentoruar nga pedagogu i lëndës së praktikës si dhe nga Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës. Shumë nga studentët në këtë program duke qenë se disponojnë një diplomë të nivelit Bachelor tashmë, janë njëkohësisht të punësuar në institucione të ndryshme, kryesisht të fushës së studimeve të tyre, dhe praktiken mund ta deklarojnë edhe pranë institucioneve ku ata punojnë.</p> <p><i>Evidenca 23. Institucionet bashkëpunuese me UL</i> <i>Evidenca 32. Institucionet ku janë kryer praktikat mesimore</i> <i>Evidenca 25. Raporti mbi Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</i> <i>Tabela 10. Plani mesimor per Programin e studimit</i> <i>Evidenca 106. Politika e Jashtme për Mobilitetin e Stafit Akademik</i> <i>Evidenca 107. Politika e Jashtme për Mobilitetin e Studenteve</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se ka raporte në nivel institucioni, por Departamenti i Administrimit Biznesit që mbulon programin e studimit MSHME duhet të hartojë në mënyrë periodike, raporte analitike duke pasqyruar specifikisht përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 28. Raporti Vjetor 2021-2022</i> <i>Evidenca 129. Raporti Vjetor 2019-2020</i> <i>Evidenca 130. Raporti Vjetor 2020-2021</i> <i>Evidenca 25. Raporti mbi Marrëveshjet e Bashkëpunimit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>IAL ka një sërë marrëveshjesh me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat, duke patur parasysh edhe numrin e vogël të studentëve, por sugjerohet që të analizohen përfitimet e këtyre marrëveshjeve në nivel program studimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënljore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit MSHME janë të përcaktuara qartë. Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Ekzekutiv realizohet sipas Rregullores së Programit, në përputhje me përcaktimet e Rregullores së Fakultetit Ekonomik dhe Rregullores së DAB. Programi është realizuar në lëndë/module sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Viti akademik ndahet në dy semestra, me 30 javë mësimore, nga 15 javë për çdo semestër. Në fund të programit studenti grumbullon 120 kredite (ECTS). Ndarja e lëndëve në këtë program është referuar veprimtarive formuese nga A - E duke sipas VKM 41 datë 24.01.2018, të ndryshuar. (3 lëndë me 8 ECTS, 6 lëndë me 7 ECTS, 4 lëndë me 6 ECTS, Praktika me 12 ECTS dhe diploma me 18 ECTS). Kurikula e MSHME përmban dy lëndë me zgjedhje.</p> <p>Në total Master i Shkencave në Menaxhim Ekzekutiv ka 120 ECTS.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore FE</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e DAB</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Programit MSHME</i> <i>Evidenca 61. Planet Mesimore MSHME</i> <i>Tabela 9. Plani Mesimor me disiplinat perkatese sipas VKM Nr. 41, dt. 24.1.2018, e ndryshuar.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të</p>	<p>Programi i studimit MSHME" synon formimin e shprehive të vecanta në larmi profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në fushen e menaxhimit duke përfshirë aspekte si të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushes së ekonomise dhe menaxhimit. Më konkretisht programi i studimit MSHME, i ka shprehur këto elementë në kurikulën e programit dhe syllabuset e lëndëve e moduleve. Për përvetësimin e njohurive dhe aftësive të vecanta në MSHME, institucioni ka parashikuar thellimin e studimeve si në njohuri bazë ashtu edhe në ato të specialitetit. Programi përmban lëndë e module të cilat kanë karakter multi-disiplinor, gje që i shërben formimit të gjithanshëm të studenteve. Zhvillimi i këtyre lendeve dhe moduleve shprehet në Planin Mesimor dhe Rregulloren e Fakultetit Ekonomik dhe atë të DAB. Në hartimin e programit janë marrë parasysh: zhvillimi dhe nevojat e tregut të punës, dinamikat e zhvillimit të biznesit si edhe sipërmarrja e lirë, të pasqyruara në Evidencën mbi Studimin e Tregut</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 15

<p>specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>të Punes. Programi i studimit MSHME mundëson zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të avancuara në fushen e politikave të zhvillimit, të menaxhimit të biznesit, financiar, atë të BNj, të ndryshimit dhe rritjes së projekteve, të marketingut, por edhe të sistemeve të informacionit, si dhe disiplina integruese sic janë: qeverisja e korporatave, ekonomiksi i punës dhe lidhshirë drejta e biznesit, që studentët të përgatiten në menyre gjithëpërfshirëse për realitetin lokal, rajonal dhe global të ekonomisë, marrëdhënieve të biznesit dhe të punëmarrësve. Programi synon të formojë ekspertë dhe specialistë si në aspektet teorike ashtu edhe në aftësitë praktike në fushen e menaxhimit ekzekutiv në institucione publike si dhe në sektorin privat.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore FE</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e DAB</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Prograrnit MSHME</i> <i>Evidenca 61. Planet Mesimore MSHME</i> <i>Evidenca 34. Strategjia e Marketingut te DAB</i> <i>Evidenca 35. Studimi per tregun e punes</i> <i>Evidenca 8. Plani Strategjik i Zhvillimit te FE</i> <i>Evidenca 11. Strategjia e Zhvillimit le Program it MSHME</i> <i>Evidenca 12. Strategjia e Zhvillimit te DAB</i> <i>Evidenca 22. Model i Suplementit le Diplomes</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit MSHME" ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Lendet në përmbajtje të kurrikulës janë të organizuara në kategoritë (A-E), sipas VKM Nr. 41 datë 24.01.2018, të ndryshuar. Kategoria D ku përfshihet praktika profesionale ka 12 kredite dhe sipas planit mesimor të masterit shkencor, praktika profesionale realizohet në sem. II e dytë të vitit të dytë të studimeve. Kohezgjatja dhe afatet për kryerjen e praktikës profesionale përcaktohen në strukturën e vitit akademik. Studenti, pasi ka përmbyllur me sukses të gjitha kërkesat e programit të studimit të Ciklit të Dytë, fillon tezën e diplomës në semestrin e fundit. (kategoria E e detyrimeve përmbyllëse dhe është vlerësuar me note dhe me 18 kredite ECTS, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe sipas Rregullores së Provimeve dhe te FE.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore FE</i> <i>Evidenca 36. Rregullore e Provimeve</i> <i>Evidenca 39. Udhezues per zhvillimin e praktikës</i> <i>Evidenca 40. Formulari dhe Pasqyra e Praktikës</i> <i>Evidenca 37. Rregullore e Diplomimit</i> <i>Evidenca 38. Udhezues per Pergatitjen e Punimit te Diplomes</i> <i>Evidenca 30. Miratimi i Formes se Diplomes dhe Numrit Unik te Identifikimit</i> <i>Evidenca 22. Model i Suplementit te Diplomes</i></p>

	Evidenca 31. Vendim Senati Akademik per Miratimin e Formes dhe Supplementit te Diplomes
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	NA
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	NA
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Në UL format e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi realizohen në përpulhje me Ligjin 80/2015 per Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor dhe specifikat perkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të MAS. Programi i studimit MSHME është hartuar dhe ofrohet në përputhje me Ligjin 80/ 2015 në lidhje me format e organizimit të studimeve, pranimin e studenteve dhe financimin e tyre ne UL. Evidenca 7. Rregullore FE Evidenca 41. Politikat e pranimit te studenteve Evidenca 42. Relacion per Planifikimin Buxhetor Evidenca 43. Vendim per miratimin e kuotave te pranimit per programin e studimit Evidenca 44. Vendim per miratimin e kriterëve te pranimit per programin e studimit Tabela 18. Te ardhurat Buxhetore

<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit "Master i Shkencave në Menaxhim Ekzekutiv" ofrohet nga departamenti i Administrim Biznesit dhe në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit Luarasi, të Fakultetit Ekonomik dhe me misionin dhe me qëllimin e DAB, që lidhet me fushën e biznesit dhe menaxhimit. Ai i është i ngjashëm me programin Master që ofrohet nga Universiteti i Tiranës në Fakultetin e Ekonomisë (Master i Shkencave Administrim Biznesi). Kjo ngjashmëri ka lidhje me fushën e njëjtë të studimit, menaxhimin.</p> <p><i>Evidenca 12. Strategjia e Zhvillimit le DAB</i> <i>Evidencall. Strategjia e Zhvillimit te Programit MSHME</i> <i>Evidenca 61. Planet Mesimore MSHME</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>UL në mbështetje të nenit 86 të Ligjit nr. 80/2015, Vendimit nr. 310, datë 11.05.2022 të Këshillit të Ministrave "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë" si dhe Udhëzimit nr. 31, datë 15.11.2022 të MAS "Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit...", ka bërë propozimet e argumentuara për kodifikimin e programeve të studimit që ofrohen aktualisht nga Fakulteti Ekonomik. Kodi i propozuar për programin e studimit MSHME është 72MS-0413-S. Propozimet janë përcjell MAS. UL është në pritje të aprovimit të propozimeve për kodifikimin e programeve. Sipas vlerësimit të GVJ procesi i kodifikimit nuk është përfunduar, por mbetet ende në proces. Programi MSHME i përket KSHK, me numrin unik të direktivave dhe udhëzimeve të identifikimit në regjistrin e diplomave të regjistruara në Ministrinë e Arsimit në Republikën e Shqipërisë. Ky program i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p><i>Evidenca 18. Propozime mbi Kodifikimin e Programeve te Studimit</i> <i>Evidenca 6. Urdher MAS per Hapje Programi MSHME</i> <i>Evidenca 7. Rregullore FE</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e DAB</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Programit MSHME</i> <i>Evidenca 30. Miratimi i Formes se Diplomes dhe Numrit Unik te Identifikimit</i> <i>Evidenca 19. Planet Mesimore MSHME</i></p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>NA</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit ofrohet në përputhje me kriteret/kërkesat ligjore si përsa i përket organizimit të programit, ndarjes në ECTS ashtu edhe kriteret e pranimit. Programi duhet të vijojë procedurën që të përmbushë</i></p>

	<i>kriterin e kodifikimit sipas udhëzimeve dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njesia kryesore, Fakulteti Ekonornik, Departamenti i Administrim Biznesit është përgjegjës për programin e studimit MSHME. Ato i përmbushin detyrimet e përcaktuara ne legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>FE përbehet nga 3 departamente;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti Administim Biznes • Departamenti Financë Bankë • Departamenti i Ekonomiksit <p>Departamenti Administrim Biznes ofron programin e ciklit i studimeve Bachelor në Administrim Bimes, ndërsa në Ciklin e dytë ofron programet Master i Shkencave në Menaxhim Ekzekutiv dhe Master Profesional në Marketing dhe Reklama .</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë drejtohet nga Dekani, i cili zoteron titullin akademik Prof. As. Dr ne perputhje me Ligjin e Arsimit te Lartë 80/2015. Përgjegjesi i Departamentit, në përmbushje të këtij Ligji, ka gradën shkencore "Doktor".</p> <p>Fakulteti Ekonomik ka aktualisht në përberjen e tij 53 pedagogë: 2 me titullin Prof. Dr, 9 me titullin akademik Prof. As. Dr., 22 janë me gradë shkencore Doktor Shkencash, 5 janë Doktorante dhe 15 Msc.</p> <p>Departamenti Administrim Biznesit ka në përberje 7 pedagogë të stafit akademik efektiv: 2 me titullin Prof. As. Dr., 2 me titullin Doktor., 2 janë Doktorante dhe 1 MSc., ndërsa pedagogë të stafit akademik me kontratë ka 8, nder të cilet 2 me titullin Prof. As. Dr., 5 me Doktor, dhe 1 me MSc.</p> <p>UL ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional për 6 vite. Politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, përcaktohen qartë në Rregulloren e UL, në përputhje me dokumentet e NJBSC të Universitetit.</p> <p><i>Evidenca 3. Statuti i UL</i></p> <p><i>Evidenca 19. Certifikata e Akreditimit Instihlcional</i></p> <p><i>Evidenca 1. Vendimi per hapjen e UL</i></p> <p><i>Evidenca 2. Urdher Riorganizim Institucional</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 19

	<p><i>Evidenca 27. Struktura Organizative e UL</i> <i>Evidenca 15. Struktura Organizative FE</i> <i>Evidenca 14. Vendim per Hapje Programesh FE</i> <i>Evidenca 6. Urdher MAS per Hapje Programi MSHME</i> <i>Evidenca 4. Rregullore e UL</i> <i>Evidenca 7. Rregullore FE</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e DAB</i> <i>Tabela 1. Te dhena Tabelore per personelin akademik ne Njesine kryesore</i> <i>Evidenca 45. Ngarkesa totale e personelit akademik le programit (Viti akademik 2022 - 2023)</i> <i>Tabela 6. Cilesia e stafit mesimdhene per programin e studimit</i> <i>Tabela 3. Te dhena Tabelore per numrin e programeve ne FE</i> <i>Tabela. 7. Të dhëna përmbledhëse të stafit akademik për programin Msc Menaxhim Ekzekutiv, sipas kualifikimit dhe raporti mes tyre</i> <i>Tabela 13. Ngarkesa totale në auditor e studentëve</i> <i>Tabela 4. Tabela treguese e angazhimit te personelit akademik per vitin akademik dhe ngarkesa perkatese</i> <i>Evidenca 29. Te dhena per kerkimin sbkencor te stafit akademik te Programit</i> <i>Tabela 12. Programi i Studimit me pedagoget dhe lendet dhe oret perkatese</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjisllacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Praktika mësimore është lëndë e cila zhvillohet nga një pedagog përgjegjës për leksionet përkatëse dhe ndjekjen e mbledhjen e dokumentacionit përkatës që ndihmon kryerjen e saj në institucione apo biznese. Lënda ka kreditet sipas planit mësimor dhe Rregullores së Programit përkatës, zhvillohet sipas Udhëzuesit të Praktikave Mësimore pranë institucioneve/bizneseve pritëse. Gjithashtu ky program studimi nuk parashikon orë laboratorike e klinike në laboratorët e FE-së. <i>Evidenca 40. Formulari dhe Pasqyra e Praktikes</i> <i>Evidenca 61. Planet Mesimore MSHME</i> <i>Evidenca 21. Programet mesimore te lendeve te programit MSHME Syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Kordinator i programit të studimit është drejtuesi i departamentit të Adminsitrim Biznesit. Ai njeher legjisllacionin e arsimit të lartë, zotëron aftësi bashkërendimi dhe menaxhimi, ka aftësi të mira për të zgjidhur problemet dhe për të marrë vendime, aftësi për të ndërtuar dhe mbajtur partneritete me bashkëpunëtorët, aftësi të mira komunikimi.</p>

Konkluzione	<i>Njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për zbatimin dhe mbikqyrjen e programit të studimit përmbushin kriteret ligjore për numrin e stafit me tituj dhe grada si dhe përsa i përket akteve të tjera të brendshme rregullatore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Fakulteti Ekonomik/ Departamenti i Administrimit të Biznesit në UL, që është përgjegjës për programin Msc. "Menaxhim Ekzekutiv" disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p>I gjithë informacioni në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit, gjenden të publikuara në "Share Point" të brendshëm të Universitetit "Luarasi". Departamenti dhe çdo anetar i personelit akademik dhe administrativ, ka akses të plotë jo vetëm tek statuti e Rregullorja e institucionit, por edhe tek planet mësimore, syllabus-et, Rregulloret e programeve të studimit, si edhe aktet e tjera rregullatore të Universitetit "Luarasi". Studentet e programit të studimit marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët e modulet e tij. Syllabus-et dhe materialet e leximit për secilën lëndë, nga semestri i dytë i vitit akademik 2018/2019 hidhen edhe në sistemin "moodle" të pershtatur nga grupi i brendshëm i zhvillimit të aplikacioneve IT në Universitetin "Luarasi". Të dhënat e detajuara për programin e studimeve gjenden edhe në faqen e internetit të Universitetit "Luarasi".</p> <p><i>Evidenca 10. Rregulloret e Programit MSHME</i></p> <p><i>Evidenca 61. Planet Mesimore MSHME</i></p> <p><i>Tabela 9. Plani Mesimor i ndare sipas Veprimtarive Formuese A-E</i></p> <p><i>Evidenca 46. Raport për projektet Luarasi</i></p> <p><i>Evidenca 47. Udhezues për përdorimin e Strukturës së it-Moodie tutorial</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën	<p>Plani mësimor i programit të studimit MSHME merr parasysh objektivat formuese dhe kompetencat profesionale që duhet të ofrojë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018), "Për Elementet e Programeve të Studimit". Ndarja e lëndëve dhe moduleve i përgjigjet plotësisht këtyre kategorive të percaktuara. Plani mësimor</p>

<p>mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>përfshin lëndët, praktikën mësimore dhe Tezën e Diplomes, si edhe ka karakter shume disiplinor.</p> <p>Plani Mësimor i këtij programi gjatë vitit të parë përmban 345 orë Leksion, 285 orë seminar (630 orë total në auditor), 870 orë punë e pavarur, ndersa gjate vitit të dytë 435 ore leksion, 165 orë seminar (600 ore total ne auditor) dhe 900 orë pune e pavarur jashtë auditorit.</p> <p><i>Evidenca 61. Planet Mesimore MSHME</i> <i>Tabela 9. Plani mesimor i ndare sipas Veprimtarive Formuese (A-E)</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Programit MSHME</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Msc. "Menaxhim Ekzekutiv" përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentet që lidhen me: kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Në rregulloren e programit të studimit në pikën "Kushtet për regjistrimin në programin e ciklit të dytë të studimit MSc "Menaxhim Ekzekutiv" parashikohen detaje në lidhje me kushtet dhe kriteret që duhet të plotesohen për t'u pranuar në programin e studimit. Po ashtu dhe në pikën "Transferimi i studentëve" të përcaktohet procedura dhe kriteret për transferimin e studimeve.</p> <p><i>Evidenca 10. Rregullore e Programit MSHME</i> <i>Evidenca 41. Politika e pranimit te studenteve</i> <i>Evidenca 110 Kontrate e Regjistrimit te Studentit (Transferimi)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Msc. "Menaxhim Ekzekutiv" përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Ndërkohë në rregulloren e programit të studimit, por edhe në syllabus-et e lëndëve përcaktohen rregullat për nivelin e frekuentimit të mesimit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, sistemin e vlerësimit, zhvillimin e provimeve, etj. Informacioni i datajuar për secilën lëndë të programit të studimit paraqitet në syllabus-in e lëndës, i cili duhet të miratohet përpara fillimit të vitit akademik edhe nga Titullari i Lëndës përveç përgjegjësit të Departamentit. GVJ ka verifikuar Syllabuset e programit (Evidenca 21) nëse kanë për përmbushur kriteret sipas VKM 41/2018 e ndryshuar (Shtojca nr. 2) si dhe verifikimit të Planit mësimor respektiv 2022-20223 të miratuar (Evidenca 61). Nga evidentimi u konstatuan:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Në të gjitha lëndët (syllabuset) mungon paraqitja e Tipologjisë së lëndës sipas gërmëzimit dhe PM miratuar;</i> • <i>Në 2 (dy) lëndë paraqiten mosperputhje e nr.krediteve të paraqitura në syllabus me nr. e krediteve respektive të lëndës në planin mësimor të miratuar të miratuar 2022-2023 (Ev.61);</i> • <i>Në 8 (tetë) lëndë mungon shpjegimi i cdo teme shoqëruar me literaturën përkatëse të detajuar me faqe;</i> • <i>Në 5 (pesë) lëndë literature e detyrueshme paraqitet me vit botimi jo brenda 5 viteve të fundit</i>

	<p><i>Evidenca 10. Rregullore e Programit MSHME</i> <i>Evidenca 11. Programi i studimit</i> <i>Evidenca 21. Programet mesimore te lendeve (Syllabuset)</i> <i>Evidenca 61. Planet mesimore</i> <i>Tabela 14. Model Programi Mesimor (Syllabusi)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Përbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p> <p>Me saktësisht programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyre periodike.</p> <p><i>Evidenca 69. Procedura per Rishikimin e Kurrikules</i> <i>Evidenca 70. Rregullore e zyres se Kurrikules</i> <i>Evidenca 96. Rregullore Sekretari Arkivit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi është në përputhje me kriteret ligjore, i strukturuar si dhe përmban objektiva formues të përshtatshëm për ciklin e studimit. GVJ konstaton se duhet të përmirësohen Syllabuset e programit në përmbushje të kriterëve sipas VKM 41/ 2018 e ndryshuar (Shtojca nr. 2).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënë, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Ekzekutiv bazohet në kurikulën e hartuar, e cila detajohet në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve. Emërtimi i programit është në përputhje me fushën e studimit që mbulon programi. Gjithashtu, emërtimi i lëndëve që përmban ky program studimi, kategorizimi dhe shpërndarja e lëndëve janë të tilla që u mundësojnë studentëve të këtij programi studimi fitimin e njohurive dhe aftësive në fushën e menaxhimit ekzekutiv. Lëndët janë në përputhje të plotë me emërtimin e programit. Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit MSHME janë ndërtuar të tilla që të mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme edhe/ose punësimin e studentëve dhe në funksion të stimulimit të mendimit të tyre krijues/novator dhe kritik.</p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e UL</i> <i>Evidenca 7. Rregullore FE</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e DAB</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Programit MSHME</i></p>

	<p><i>Evidenca 61. Planet Mesimore MSHME</i> <i>Evidenca 8. Plani Stratejik i Zhvillimit le FE</i> <i>Evidenca 35. Studimi per tregun e punes</i> <i>Evidenca 66. Misioni dhe Studimi i Tregul UL</i> <i>Evidenca 12. Strategjia e Zhvillimit te DAB</i> <i>Evidenca 34 Strategjia e Marketingut le DAB</i> <i>Evidenca 26. Rregullore e Zyres se Markelingul</i> <i>Evidenca 71. Strategjia e Kerkimit Shkencor</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Ekzekutiv" bazohet në kurrikulën e hartuar, e cila detajohet në planin mesimor dhe syllabuset e lendeve/moduleve. Programi i studimit është organizuar për t'i dhënë studentëve njohuritë e nevojshme që u krijohet mundësia për t'u punësuar në sektore të ndryshem të ekonomisë.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore FE</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e DAB</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Programit MSHME</i> <i>Evidenca 28. Raporti Vjetor 2021-2022</i> <i>Evidenca 49. Te dhena mbi diplomimin dhe punesimin e studenteve</i> <i>Evidenca 21. Programet mesimore te lendeve te programit MSHME (Syllabuset)</i> <i>Evidenca 12. Strategjia e Zhvillimit te DAB</i> <i>Evidenca 35. Studimi per tregun e punes</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Lëndët dhe modulet që përmban dhe emërtimi i tyre janë në përputhje me drejtimin dhe profilin e studimit për ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave. Natyra e moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike të informacionit që jep një modul dhe aplikimeve të mundshme praktike.</p> <p>Për ngritjen e këtij programi studimi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës kurrikulare janë shfrytëzuar eksperiencia ndërkombëtare nga vende të zhvilluara.</p> <p><i>Evidenca 61. Planet Mesimore MSHME</i> <i>Evidenca 28. Raporti Vjetor 2021-2022</i> <i>Evidenca 129. Raporti Vjetor 2019-2020</i> <i>Evidenca 35. Studimi per tregun e punes</i> <i>Evidenca 12. Strategjia e Zhvillimit te DAB</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Për të mundësuar arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve, programi i studimit ofron një ndërthurje midis formimit teorik, kërkimor dhe praktik. Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>

<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Lidhur me përditësimin e syllabuseve për këtë program, GVJ ka verifikuar Syllabuset e programit¹ (Evidenca 21) dhe nga evidentimi u konstatuan se në 5 (pesë) lëndë literata e detyrueshme paraqitet me vit botimi 2011, 2012 dhe 2014.</p> <p>Evidenca 21. Programet mesimore te lendeve (Syllabuset) Evidenca 61. Planet mesimore</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit u mundëson dhe u garanton studentëve përfitim të dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave profesionale, të cilat përbejnë edhe synimet e këtij programi të percaktuara edhe në rregulloren e fakultetit, të depaiamentit dhe të programit.</p> <p>Përmbajtja e syllabuseve të lendeve, të cilat japin në mënyrë të detajuar përmbajtjen e çdo lënde, shprehur nëpërmjet temave që zhvillohen gjatë trajtimit të disiplinave përkatëse e garanton këtë gjë.</p> <p>Organizimi i programit të studimit, lëndet e ofruara janë në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studenteve. Studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke u dhënë mundësi të plotësojnë njohuritë dhe të sqarojnë paqartësitë gjatë semestrit.</p> <p>Evidenca 4. Rregullore e UL Evidenca 7. Rregullore FE Evidenca 9. Rregullore e DAB Evidenca 21. Programet mesimore te lendeve te programit MSHME (Syllabuset) Evidenca 12. Strategjia e Zhvillimit te DAB Evidenca 61. Planet Mesimore MSHME Tabela 14. Model Programi Mesimor (Syllabusi)</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit të studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit MSHME u mundëson studentëve vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit të tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Misioni i programit është të zhvillojë njohuritë e thelluara ekonomike të menaxhimit të një institucioni apo bimesi në nivel ekzekutiv. Kjo dëshmohet në komponentet e planit mësimor dhe në përmbajtjen e programeve të lendeve mësimore. Ky program mundëson thellim të mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë të studimeve.</p> <p>Evidenca 4. Rregullore e UL Evidenca 7. Rregullore e FE Evidenca 9. Rregullore e DAB Tabela 14. Model Programi Mesimor (Syllabusi)</p>

¹ (Tabela e verifikimit të SYLLABUSEVE nga GVJ lidhur me përmbushjen e kriterëve të VKM 41/2018 të ndryshuar dhe Planit mesimor të miratuar të programit MSHME)

	<i>Evidenca 35. Studimi per tregun e punes</i> <i>Evidenca 12. Strategjia e zhvillimit te DAB</i> <i>Evidenca 34. Strategjia e Marketingut të DAB</i> <i>Evidenca 49. Te dhena mbi diplomimin dhe punesimin e studenteve</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se duhet të përmirësohen Syllabuset e programit në përmbushje të kriterëve sipas VKM 41/2018 e ndryshuar (Shtojca nr. 2) si dhe syllabuset duhet të përmirësohen dhe përditësohen përmes procesit të rishikimit dhe përditësimit të vazhdueshëm .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Fakulteti Ekonomik dhe programi i studimit MSHME i nënshtrohet cdo vit një analize të gjerë mësimore dhe shkencore e cila shqyrton ecurinë dhe zbatimin e programit si dhe çështje të tjera që lidhen me ecurinë e mëtejshme të studentëve. Departamenti i Administrim Biznesit, në fund të cdo viti akademik organizon mbledhje në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit. Në nivel institucional, realizohet një pyetesor studentor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga Komisioni për Standardet e Cilësisë. Gjithashtu, është nënshkruar edhe Marreveshja me "Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë" me objekt organizimin e aktiviteteve të përbashketa me fokus pjesëmarrjen në aktivitetet e ndërsjella të palëve, si dhe vendosjen e një bashkëpunimi në kuadrin e praktikës mësimore. <i>Evidenca 5. Plani Strategjik UL</i> <i>Evidenca 8. Plani Strategjik i Zhvillimit le FE</i> <i>Evidenca 12. Strategjia e zhvillimit le DAB</i> <i>Evidenca 35. Studimi per tregun e punes</i> <i>Evidence 33. Marreveshje Bashkepunimi me "Dhomen e Tregtise dhe Industrise Tirane"</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe	UL nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre. Studentët janë të angazhuar në Senatën Akademik UL. Studentët janë organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre. Qëllimi dhe mendimi i studentëve në lidhje me përmirësimin e cilësisë së këtij programi mund të merret dhe përmes instrumenteve, sic janë pyetesoret që realizohen nga strukturat e UL-se apo edhe FE dhe Departamenti.

reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	<p><i>Evidenca 54. Lista e anetareve të Senatit Akademik UL</i> <i>Evidenca 55. Rregullore e Keshillit Studentor</i> <i>Evidenca 116. Statuti i Keshillit Studentor</i> <i>Evidenca 56. Rregullore e Zyres së Studentit dhe Keshillimit të Karrieres</i> <i>Evidenca 57. Tranime/aktivitete</i></p>		
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<p>Një nga aspektet e trajtuara përgjatë analizave të fakultetit ekonomik dhe departamentit të administrimit biznesit është edhe përshtatja e programit të studimit me kushtet e reja ekonomike, sociale, juridike, etj. Strukturat përgjegjëse për zbatimin e programit konsultohen edhe me bashkëpunëtorë apo partnerë nga institucione të ndryshme publike e private. Një nga përmirësimet më të fundit lidhet me rritjen e numrit të rasteve të studimit të trajtuara përgjatë seminareve dhe shtimi i rasteve të studimit në bankën e pyetjeve të provimit përfundimtar.</p> <p><i>Evidenca 5. Plani Strategjik UL</i> <i>Evidenca 8. Plani Strategjik i Zhvillimit të FE</i> <i>Evidenca 12. Strategjia e zhvillimit të DAB</i> <i>Evidenca 35. Studimi për tregun e punës</i> <i>Evidenca 33. Marrëveshje Bashkëpunimi me "Dhomen e Tregtisë dhe Industrisë Tirane"</i></p>		
Konkluzione	<p><i>UL ka marrëdhënie të konsoliduara me aktorët e tregut të punës të cilët, ndër të tjera angazhohen edhe në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. GVJ nuk vëreu raste specifike se si ky bashkëpunim ishte reflektuar në programin e studimit nën vlerësim.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Ekzekutiv i ka të përcaktuara prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor, të pasqyruara në strategjinë e programit të studimit dhe kërkimit shkencor duke u bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, Strategjisë Kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin (2017-2022), miratuar me vendim Nr. 710, datë 1.12.2017; në përputhje me Statutin e UL; Planin Strategjik të UL dhe Strategjinë e Zhvillimit të DAB.</p> <p><i>Evidenca 3. Statuti i UL</i> <i>Evidenca 5. Plani Strategjik UL</i> <i>Evidenca 12. Strategjia e Zhvillimit të DAB</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e FE</i></p>

	Evidenca 71. Strategjia e Kerkimit Shkencor			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Fakulteti Ekonomik/ Departamenti i Administrimit të Biznesit nxit dhe bashkërendon veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. Evidenca 4. Rregullore e UL Evidenca 7. Rregullore FE Evidenca 9. Rregullore e DAB Evidenca 58. Manual i organizimit te aktiviteve ne UL			
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Departamenti ka nxitur studentët të jenë pjesëmarrës në konferenca (studentore dhe jo vetëm), seminar edhe ëorkshope/ simulime si dhe nëpërmjet detyrave të kursit, eseve, hartimit të temave të ndryshme kërkimore. Referuar Tabelës 22 si dhe nga vizita në insitucion, vihet re një i vogël (4 studentë) i përfshirjes së studentëve në punime shkencore individuale të pedagoqeve. Gjithashtu, referuar Tabelës 22, nuk ka përfshirje studentësh në tre vitet e fundit në projekte shkencore në rang departamenti/njësie apo me të tretët. Tabela 22. Aktivizimi i studenteve ne aktivitete shkencore			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Institucioni ka mbështetur Departamentin e Administrim Biznesit, në bazë materiale dhe infrastrukturë në zhvillimin konferencave promovime etj. Evidenca 59. Buxheti mbi kerkimin shkencor Evidenca 29. Te dhena per kerkimin shkencor le stafit akademik te Programit Evidenca 25. Raporti mbi Marreveshjet e Bashkepunimit Tabela 19. Aktivitete individuale shkencore te stafit akademik Tabela 20. Te dhena per Bashkepunirne shkencore jashte JAL/jashte vendi ne rang Fakulteti/programi			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se programi i studimit është në përputhje me objektivat e institucionit, menaxhohet me efektivitet nga njësia bazë dhe ka në dispozicion burimet e nevojshme për të qenë efektiv. Njësia kryesore dhe Departamenti duhet të përmirësojnë aktivizimin e studentëve të programit në projekte shkencore në rang departamenti/njësie apo me të tretët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron	DAB mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me institucione homologe dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me to për prezantime, konferenca të përbashkëta shkencore etj. Një nga bashkëpunimet me te frytshme ka qenë ai në kuadrin Projektit

<p>bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>të Western Balkan Funds: për organizimin e Konferencave Shkencore të perbashketa me Universitetet Partnere si Donja Garica, Signidunum, FON University dhe Zenica University; përshirjen e stafit në botime, editime, peer-revieë në Konferencat Shkencore të organizuara nga UL dhe nxitjen e përfshirjes së studenteve dhe produkteve të tyre shkencore. Referuar Tabelës 22 si dhe nga vizita në insitucion, vihet re një i vogël (4 studentë) i përfshirjes së studentëve në punime shkencore individuale të pedagogeve si dhe nuk ka përfshirje studentësh në tre vitet e fundit në projekte shkencore në rang departamenti/njësie apo me të tretët.</p> <p>Tabela 19. <i>Aktivitetet individuale shkencore të stafit akademik</i> Tabela 20. <i>Te dhena për Bashkëpunime shkencore jashtë IAL/jashtë vendit në rang Fakulteti/programi</i> Tabela 22. <i>Aktivizimi i studenteve në aktivitete shkencore</i> Evidenca 71. <i>Strategjia e Kerkimit Shkencor</i> Evidenca 25. <i>Raporti mbi Marreveshjet e Bashkëpunimit</i> Evidenca 24. <i>Raport për Projektet e UL</i> Evidenca 73. <i>Conference Proceedings 2020</i> Evidenca 134. <i>Conference Agenda IMCERI 2022 UL</i> Evidenca 74. <i>Udhëzues Konferencë Studentore Luarasi</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Departamenti i Administrimit të Biznesit angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik për realizimin e këtyre objektivave. DAB dhe Fakulteti Ekonomik angazhohet për të lidhur marrëveshje të reja bashkëpunimi për konsolidimin e marrëdhënieve me njësi të tjera shkencore të IAL-ve në hapësirën shqiptare; krijimi i mundësive për të integruar bashkëpunimin në programet si: Erasmus+, Eastern Balkan Funds, Horizont 2020 etj. Sa u përket studentëve, Referuar Tabelës 22 si dhe nga vizita në insitucion, vihet re një numër i vogël (4 studentë) i përfshirjes së studentëve në punime shkencore individuale të pedagogeve si dhe nuk ka përfshirje studentësh në tre vitet e fundit në projekte shkencore në rang departamenti/njësie apo me të tretët.</p> <p>Evidenca 60. <i>Lista e marreveshjeve Erasmus +</i> Evidenca 23. <i>Institucionet bashkëpunuese me UL</i> Evidenca 12. <i>Strategjia e zhvillimit të DAB</i> Evidenca 71. <i>Strategjia e Kerkimit Shkencor</i> Evidenca 72. <i>Conference Proceedings 2019</i> Evidenca 73. <i>Conference Proceedings 2020</i> Evidenca 134. <i>Conference Agenda IMCERI 2022 UL</i> Evidenca 106. <i>Politika e Jashhne për Mobilitetin e Stafit Akademik</i> Evidenca 107. <i>Politika e Jashhne për Mobilitetin e Studenteve</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose</p>	<p>Me mbështetjen e strukturave të UL, departamenti Administrim Biznesit organizon dhe mbështet realizimin e konferencave kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare. Sa u përket studentëve, Referuar Tabelës 22 si dhe</p>

<p>aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>nga vizita në insitucion, vihet re një numër i vogël (4 studentë) i përfshirjes së studentëve në punime shkencore individuale të pedagogëve si dhe nuk ka përfshirje studentësh në tre vitet e fundit në projekte shkencore në rang departamenti/njësie apo me të tretët.</p> <p>Tabela 19. <i>Aktivitete individuale shkencore te stafit akademik</i> Tabela 20. <i>Te dhena per Bashkepunime shkencore jashte IAL/jashte vendi ne rang Fakulteti/programi</i> Tabela 22. <i>Aktivizimi i studenteve ne aktivitete shkencore</i> Evidenca 71. <i>Strategjia e Kerkimit Shkencor</i> Evidenca 25. <i>Raporti mbi Marreveshjet e Bashkepunimit</i> Evidenca 24. <i>Raport per Projektet e UL</i> Evidenca 73. <i>Conference Proceedings 2020</i> Evidenca 134. <i>Conference Agenda IMCERI 2022 UL</i> Evidenca 74. <i>Udhezues Konference Studentore Luarasi</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit synon të formojë profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Kjo deshmohet edhe në evidence mbi punësimin e studentëve, të cilët janë punësuar me së shumti në pozicione në perputhje me diplomën e tyre. Në kuadër të projektit Western Balkan Funds me 4 universitete partnere rajonale është zhvilluar një ëorkshop lidhur me zbulimin e mundësive të punësimit në Rajonin e Ballkanit.</p> <p>Evidenca 12. <i>Strategjia e Zhvillimit te DAB</i> Evidenca 49. <i>Te dhena mbi diplomimin dhe punesimin e studenteve</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>NA</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>NA</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se programi garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe përpjekje për kërkim shkencor dhe departamenti duhet te intensifikojë numrin e projekteve kërkimore të fituara në funksion</i></p>




	<i>të programit si dhe rritjen e përfshirjes së studentëve në projekte kërkimore-shkencore.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në forma të ndryshme të e mësimdhënies, mësimnxënies. Në bazë të rregullores së institucionit në evidencën 10, Tabelës 13 në RVB dhe syllabus siç jepet në Evidencën 21, formati kryesor i mësimdhënies përfshin sa më poshtë në orë auditori:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione 495 orë mësimore - Seminare 465 orë mësimore - Praktikë profesionale 100 orë mësimore - Diploma/Provim Formimi 170 orë mësimore <p><i>Evidenca 10. Rregullore e Programit MSHME</i> <i>Tabela 14. Model Programi Mesimor (Syllabus)</i> <i>E21: Syllabusest</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik zhvillon mësimdhënien në forma, mënyra, metoda të ndryshme për t'ju përgjigjur larmisë dhe nevojave të studentëve, praktikë kjo e evidentuar edhe nga takimet në institucion. Universiteti ka vënë në dispozicion edhe LMS "Moodle Luarasi".</p> <p>Praktika që ndiqet për të analizuar çfarë sugjerimesh dhe kërkesash janë marrë nga studentët, si janë zbatuar dhe ndjekur ato, dhe çfarë praktikash të tjera janë përshtatur me nevojat e studentëve për secilën lëndë të programit mund të specifikohet më mirë në rregullore.</p> <p>Fakti që studentët kanë mundësi të ndjekin praktika mësimore pranë kompanive është pozitiv megjithëse, duke qenë të punësuar gjatë kohës së studimeve, studentët i ndjekin praktikat kryesisht pranë kompanive të tyre</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Universiteti "Luarasi" ka miratuar Udhëzuesin e Metodave Inovative të mësimdhënies", I cili shpjegon cilat janë elementet kryesore të planifikuara në mbështetje të zhvillimit të stafit akademik të universitetit.</p> <p><i>GVJ sugjeron që këto aktivitete të pasqyrohen në raporte të cilat të analizojnë sa anëtarë stafi marrin pjesë në këto trajnime në përgjithësi dhe nga MSh. ME në shqyrtim, dhe sa efektive kanë qenë këto trajnime në rezultatet e pritura.</i></p> <p><i>Evidenca 90 dhe 100</i> <i>E 82 Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe</p>	<p>Kompetenca e stafit akademik për mësimdhënie jepet e mirëqene. Shpjegohet se stafi akademik angazhohet në nxitjet e studentëve dhe mësimxënie nëpërmjet detyrave të kursit dhe aktiviteteve për çdo lëndë.</p>

<p>koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>UL, sipas evidences 90, por edhe NJSBC organizon trajnime me stafin akademik, në kuadër të mësimdhënies, çdo vit akademik.</p> <p>RVB referon se stafi akademik është përgjegjës edhe për mentorimin e studentëve me qëllim arritjen e objektivave profesionale dhe akademike. Pedagogët e çdo lënde duhet të sigurohen që pavarësia dhe mësimi i studentëve nuk kufizohet vetëm në anën praktike, po dhe në anën konceptuale.</p> <p><i>Për këtë duhet më tepër evidencë në lidhje me metodat e nxitjes së debatit, diskutimit dhe mendimit ndryshe në klasa, sa të hapur janë pedagogët e lëndëve për të pranuar mendime ose përgjigje alternative nga studentët. Evidenca 105</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konfirmoi gjatë vizitave në institucion dhe shyrtime të evidencave se institucioni është në vlerësim të vazhdueshëm të formave mësimore dhe përmirësimit të tyre në bazë të, kryesisht, vlerësimeve që vijnë nga vetë studentët. Përditësimi i anës shkencore nga ana tjetër bëhet nga pedagogët nën mbikëqyrjen e departamentit dhe drejtueses së programit. Gjatë takimit me trupën akademike, u referua se bëhet përditësim i syllabuseve dhe materialeve. Këto ndryshime bëhen nga pedagogët duke marrë parasysh edhe vlerësimet e studentëve në një proces të mbikëqyrur nga departamenti.</p> <p><i>GVJ sugjeron që këto ndryshime të pasqyrohen edhe në syllabuset e lëndëve, pasi evidenca 21 përmaban literaturë përtej 5 vjeçarit të fundit. Kurse Evidenca 115 jep analize të gjithë programeve të studimit. Sugjerohet të bëhet një analizë e vecantë për programin e studimit. Evidencat 21, 118, 120, 127, 115</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Universiteti “Luarasi” ka miratuar Udhëzuesin e Metodave Inovative të mësimdhënies” edhe NJSBC organizon trajnime me stafin akademik, në kuadër të metodave të mësimdhënies me qëllim përmirësimin e aftësive të stafit akademik.</p> <p><i>GVJ rekomandon të paraqitet dhe një informacion më i saktë sa pedagogë marrin pjesë në secilin trajnim, dhe të analizohet nëse rezultatet e atyre që marrin pjesë rezultojnë më të larta në mësimdhënie në krahasim me ata që nuk marrin pjesë në trajnime. Evidenca 12, 122</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Strukturara e lëndëve të programit duket e standardizuar në peshë leksionesh, seminaresh e provimesh.</i></p>

	<i>GVJ sugjeron që aktivitetet trajnuese të pasqyrohen në raporte të cilat të analizojnë sa anëtarë stafi marrin pjesë në këto trajnime në përgjithësi dhe nga MShME, dhe sa efektive kanë qenë këto trajnime në rezultatet e pritura.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Sipas programeve të lëndëve (evidenca 21) tregohet qartë se vlerësimi i studentëve bëhet bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - provimin përfundimtar - provimin e ndërmjetëm - pjesëmarrjes aktive - prezantimet e detyrave të kursit <p>por përqinja e secilit komponent ndryshon në varësi të lëndës. Përveçse në syllabuset përkatëse kur regjistrohen për programin e studimit, studentët njihen me mënyrat e vlerësimit sa më sipër dhe në fillimin e çdo lënde.</p> <p><i>Evidenca 21. Programet mësimore të lëndëve të programit MSHME (Syllabuset)</i></p> <p><i>Evidenca 10. Rregullore e Programit MSHME Programi i studimit</i></p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Specifikimet e çdo lënde përkatëse jepen nëpërmjet syllabuseve sipas evidencës 21 specifikisht për programin MSh ME.</p> <p>Aty studentet informohen për përmbajtjen e lëndës dhe mënyrën e vlerësimit kur regjistrohen dhe në fillim të çdo lënde.</p> <p><i>Evidenca 21. Programet mësimore të lëndëve të programit MSHME (Syllabuset)</i></p>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Rregullorja e programit paraqit qartë lëndët dhe njohuritë që marrin studentët nga ky program. Testimi dhe vlerësimi i njohurive ne programin e studimit Msh ME bëhet në mënyrë shume diverse dhe kumulative. Gjithsesi, provimi përfundimtar mbetet mënyra kryesore dhe standarde e vlerësimit për gati të gjitha lëndët.</p> <p><i>Evidenca 21. Programet mësimore të lëndëve të programit MSHME (Syllabuset)</i></p> <p><i>Evidenca 134 Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive</i></p>

Konkluzione	<i>Sipas programeve të lëndëve (evidenca 21) tregohet qartë se vlerësimi i studentëve bëhet në mënyrë diverse dhe kumulative, por përqindja e secilit komponent ndryshon në varësi të lëndës.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Lëndët e programit MshME janë semestrare. Testimi i njohurive kryhet gjatë gjithë semestrit në lëndë të ndryshme dhe nga komponenti i vlerësimit për pjesëmarrjen varion 10-20%. Megjithëse kjo përqindje është e ulët në krahasim me peshën e provimeve, konsiderohet se është e kënaqshme për të inkurajuar studentët të mbeten të angazhuar. <i>Evidenca 21. Programet mësimore të lëndëve të programit MSHME (Syllabuset)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Universiteti përdor sisteme elektronike për mësimdhënie dhe menaxhimin e provimeve, si Platforma "Moodle Luarasi LMS" dhe Platforma Office 365. <i>Evidenca 4. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Moodle tutorial</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Bazuar në evidencën 21, vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe Megjithatë, GVJ konstatoi gjatë vizitave në institucion si edhe kontrolli I evidences 21 që syllabuset nuk kanë një titullar lënde, sipas bazës ligjore në fuqi. <i>Përfshirja e dy pedagogëve ku njëri është titullari i lëndës, garanton cilësinë dhe mund të shtrihet edhe në hartmin e tezave dhe monitorimin e procesit të provimit.</i> <i>Evidenca 21. Programet mësimore të lëndëve të programit MSHME (Syllabuset)</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga takimi me studentët GVJ u informua që ata që në fillim të lëndës orientohen nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe detyrimeve të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me menyrën se si do të realizojnë këtë detyrë kursi apo projekt, i cili në fund të lëndës apo modulit prezantohet nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të modulit (kjo bëhet në forma të ndryshme sipas rastit në ppt, etj. në orët e fundit të seminareve). Një procedurë e tillë mundëson marrjen e feedback-ut si nga pedagogu ashtu dhe nga studentët e tjerë në lidhje me aspektet pozitive të punimit

	<p>apo elementët që kanë nevojë për përmirësim apo detajim të mëtejshëm. Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/ përmirësojnë aftësitë e tyre prezantuese.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Departamenti i Administrim Biznesit, si njësi bazë që ofron programin e studimit MshME dhe stafi akademik i angazhuar në program marrin masa ndaj studentëve për të shmangur plagjiaturën në detyrat e tyre të kursit. Gjithashtu, komisioni përgjegjës për provimet e secilës lëndë, ndalon në mënyrë të rrepte kopjimin në provimet e ndërmjetme apo në ato përfundimtare.</p> <p><i>Evidenca 7 Rregullore FE</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Programit MSHME</i> <i>Evidenca 36. Rregullore e provimeve</i> <i>Evidenca 117 Kodi i Etikës</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Gjatë proçesit të kontrollit stafi shënon pikët për çdo ushtrim si dhe tregohet i kujdeshëm të përfshijnë të gjithë informacionet e marra gjatë zhvillimit të lëndës/ modulit. Rezultatet e provimit jepen brenda 5 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit.</p> <p><i>Evidenca 7 Rregullore FE</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Programit MSHME</i> <i>Evidenca 36. Rregullore e provimeve</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit, studentët kanë të drejtë të rishikojnë provimet. Gjithashtu, UL ka bërë aktiv sistemin PITAGORA, për të rritur transparencën e vlerësimeve të studentëve.</p> <p><i>Evidenca 7 Rregullore FE</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Programit MShME</i> <i>Evidenca 36. Rregullore e provimeve</i> <i>Evidenca 3 Statuti i UL</i> <i>Evidenca 76 Manual Studente Online</i> <i>Evidenca 77 Pitagora Manual Nota Studenti</i> <i>Evidenca 78 Pitagora Manual Publikimi i Programeve</i> <i>Evidenca 79 Pitagora Manual</i> <i>Evidenca 103 Proçesi i Vlerësimit Pitagora</i> <i>Evidenca 104 Proçesi i Mungesave Pitagora</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>UL ka procedurë të pasqyruara në rregulloret e FE, provimeve dhe ankimit të studentëve. Sipas RVB dhe takimit me studentët, ata i drejtohen Departamentit për fillimin e procedurave për ngritjen e një komisioni Ad-hoc për ri-vlerësimin e provimeve të studentëve që kanë ngritur këtë pakënaqësi.</p> <p><i>Evidenca 7 Rregullore FE</i> <i>Evidenca 36. Rregullore e provimeve</i></p>

	<i>Evidencë 132 Rregullore e Ankimimit të Studentëve</i> <i>Evidenca 96 Rregullore Sekretari Arkivit</i>			
Konkluzione	Syllabuset nuk kane titullar lende dhe jane te hartuara dhe firmosuar edhe nga staf akademik me titull Msc. Përfshirja e dy pedagogëve ku njëri është titullari i lëndës, jo vetem permbush kerkesat ligjore ne fuqi, por garanton cilësinë e lendes dhe mund të shtrihet edhe në hartmin e tezave dhe monitorimin e procesit të provimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit Msh në ME (neni 4), programi garanton thellimin e njohurive nga Bachelor në Master në nivel praktik dhe shkencor. <i>Evidenca 10. Rregullore e Programit MSHME</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Në zbatim të VKM 41, datë 24.1.2018, GVJ konstatoi se modulet janë të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse. Lëndë të tilla si “MBNJ dhe Karrieres”, “Menaxhim Marketing”, “Lidership” dhe “Menaxhim i Sistemeve të Informacionit” japin njohuri mbi përdorimin e teknologjive të informacionit, human, sociale dhe komunikimi në fushën e këtij programi MShME. GVJ sugjeron të bëhet rishikim kurrikule ku të shikohen mundësi të futjes së lëndëve të tjera më të vlefshme për menaxherë dhe administrim biznesi, si për shembull sisteme ERP (Enterprise Resource Planning) apo CRM, Gjithashtu të shtohen njohuri të thelluara për Excel, simulime biznesi, dhe njohuri mbi menaxhimin dhe vizualizimin e të dhënava.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	GVJ konstatoi se në syllabuset e çdo lënde studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulën përkatës. FE dhe departamenti, vlerësojnë kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti në mënyrë periodike dhe në fund të programit të studimit. Përmbledhjet që bëhen në fund të çdo lënde për njohuritë e marra, detyrat e kursit, si përgatitje për provimin dhe si përmbledhje praktike tregojnë plotësimin e këtij kriteri. <i>Këto praktika të sipërpërmendura do ishte e nevojshme të formalizoheshin në rregullore. Evidenca 21. Programet mësimore të lëndëve të programit MSHME (Syllabuset)</i>

<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Laboratorët nuk parashikohen në kurrikulën e MShME, por institucioni ka laborator informatike që e vë në dispozicion të studentëve.</p> <p>Kurikula e programit të studimit dhe plani mësimor, i lë në semestrin e dytë hapsirë angazhimit të tyre në praktikën profesionale. Kjo ju jep mundësinë studentëve për ti zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë.</p> <p>Nuk ka evidenca per pjesëmarrjen e studentëve në konferenca dhe punime shkencore.</p> <p>Fakti që një pjesë e detyrave të kursit kryhet në grup është pozitive. Se sa konkretisht në nivel programi dhe lëndësh nuk specifikohet. Është e nevojshme të detajohet gjithashtu edhe pesha që këto punë në grup kanë në notën e studentit për çdo lëndë duke siguruar një ndarje të drejtë të notave nga puna në grup në bazë të meritës për çdo anëtar grupi.</p> <p><i>Sa më sipër GVJ sugjeron të konsiderohen si elementë shtesë në rregulloren e MSh ME.</i></p> <p>Evidenca 21. Programet mësimore të lëndëve të programit MSHME (Syllabuset)</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni organizon leksione të hapura duke ftuar folës të jashtëm akademike ose nga biznesi. Këto leksione ofrojnë mundësi për studentët të zgjerojnë njohuritë e tyre përtej programit.</p> <p>Evidenca 57 Trajnime/aktivitete</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Stafi akademik mbështet studentet ne zhvillimin e ideve inovative, pjesmarrje në forume biznesi, por duhet edhe të inkurajoje pjesëmarrjen e studentëve në konferenca dhe punime shkencore.</p> <p><i>Një tregues i mirë mund të ishte dhe përqindja e studentëve të MSh ME që vazhdojnë studimet e nivelit të tretë për doktoratë ndoshta jashtë apo në vendet e rajonit. Pjesëmarrja në kërkimin shkencor e stafit akademik është e ulët, dhe nuk ka evidenca për punime kerkimore të studentëve. E128 e referuar në RVB paraqet punime të stafit akademik. Kurse E85, E95 paraqesin certifikata pjesëmarrje në forum biznesi dhe jo punime shkencore të referuara në konferenca apo botuara në revista shkencore. Gjatë vizitave në institucion u referua se institucioni mbështet financiarisht këto iniciativa, por departamenti dhe institucioni nuk kanë një buxhet të parashikuar posacërisht për aktivitete të tilla.</i></p> <p><i>Ndoshta, përveç mbështetjes financiare, ulja e ngarkesës mësimore do të ishte një stimul i mirë.</i></p> <p>E 85 Model Certifikate Forumi Studentor Maj 2019.pdf E 128 Publikimet e Studentëve.pdf</p>

Konkluzione	<i>GVJ sugjeron të shikohen mundësi të futjes së lëndëve të tjera më të vlefshme për menaxherë dhe administrim biznesi, si për shembull sisteme ERP (Enterprise Resource Planning) apo CRM, njohuri të thelluara për Excel, simulime biznesi, dhe njohuri mbi menaxhimin dhe vizualizimin e të dhënave. Nuk ka evidence te pjesemarrjes se studenteve me punime shkencore. Përveç mbështetjes financiare te stafit akademik, ulja e ngarkesës mësimore do të ishte një stimul i mirë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Evidenca 37 paraqet procedurën e posaçme për detyrimet përmbyllëse. Rregullat e punimit dhe dorëzimit të diplomës përcaktohen gjithashtu edhe në rregulloren e përgjithshme të institucionit. <i>E37. UL Rregullore e diplomimit.pdf</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Departamenti dhe pedagogu udhëheqës asistojnë studentin në punimin e diplomës. Institucioni ka paraqitur si evidencë listën e pedagogëve udhëheqës, në të cilën vihet re se një staf kademik ka edhe 9 studentë në udhëheqje vetëm në këtë master. <i>GVJ rekomandon të shikohet mundësia për një shpërndarje më të mirë të raportit udhëheqës/student për të mos kompromentuar cilësinë e punimeve.</i> <i>Evidenca 37. UL Rregullore e diplomimit.pdfm E3 shtesë</i>
Kriteri 3. Komisioni I posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	N/A
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit	Studentët mbështeten nga DBA për punimin e diplomës, i cili harton një listë temash të cilat pasi miratohen nga dekani i fakultetit i shpërndahen studentëve. Udhëheqësi i temës orienton studentin në punimin e saj për diplomën. Ky proces kryhet sipas rregullores së MSh ME. GVJ konstaton nga E3 shtesë e vënë në dispozicion pas vizitës në institucion se një pjesë e madhe e temave janë në fushën e finances dhe atoudhëhiqen nga staf akademik me përgatitje maxhim/marketing.

<p>përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Pedagogu udhëheqës sigurohet që studenti planifikon dhe zbaton projektin e diplomës në përputhje me interesin kërkimor, mundësit e të dhënave dhe potencialin e studimit. Institucioni vë në dispozicion laboratorin e informatikës dhe teknologjinë e informacionit përkatëse në të në shërbim të studentëve gjatë punimit të diplomës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Konfirmohet që pedagogu udhëheqës asiston studentin gjatë punimit të temës së diplomës dhe përgatit një raport paraprak sipas nje template, për komisionin e vlerësimit para se studenti të paraqitet para tij. <i>GVJ rekomandon të shikohet mundësia për orientimin e studentëve drejt realizimit të temave në fushën e menaxhimit për të vënë në praktikë dijet dhe aftësitë e synuara nga ky program studimi në fushën e menaxhimimit. Gjithashtu, sugjerohet një përshtatje më e mire e profilit të udhëheqësit dhe temës së masterit punuar nga studentët.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimin përfundimtar të studentit për punimin e diplomës e bën komisioni i mbrojtës së temave të diplomave që ngrihet posaçërisht dhe vlerëson prezantimin që studenti i bën punimit të diplomës. Studenti vlerësohet me notë e cila regjistrohet në proces-verbalin e firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studenti me mbarimin e studimeve pajiset me:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Diplomën 2. Listën e notave 3. Suplementin e diplomës <p>Këto dokumenta janë sipas formatit të miratuar nga MASR dhe të paraqitur si evidencë nga institucioni për këtë proces vlerësimi në Evidencën 30.</p> <p>Institucioni ju jep të drejtën studentëve të kërkojnë dhe të marrin një kopje të plotë të programit mësimor dhe syllabuset e lëndëve të zhvilluara të firmosur nga titullari i institucionit.</p> <p>RVB; Evidenca 22; Evidenca 30</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Të dhënat e studentëve dhe rezultatet e tyre ruhen nga sekretaria mësimore. Nga takimi konfirmohet se Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni mban të dhënat e kontaktit dhe i azhuron ato për studentët pas diplomimit.</p> <p>RVB; Evidenca 68</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ rekomandon të shikohet mundësia për orientimin e studentëve drejt realizimit të temave në fushën e menaxhimit për të vënë në praktikë dijet dhe aftësitë e synuara nga ky program studimi në fushën e menaxhimimit. GVJ rekomandon të shikohet mundësia për një shpërndarje më të mire të raportit udhëheqës/student si edhe një përshtatje më e mire e profilit të udhëheqësit dhe temës së masterit punuar nga studentët, për të mos kompromentuar cilësinë e punimeve.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi III.6
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi (Tabela 5, RVB), të cilat mundësojnë praktikat profesionale. Por studentët e MshME duke qënë kryesisht në marrëdhënie pune i kryejnë praktikat në institucionet ku punojnë. Kjo gjë pasqyrohet në E9 shtesë të venë në dispozicion pas takimeve në institucion, perban pothuajse asnje praktike ne institucionet bashkepunuese.			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfutimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N/A			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale konvertohet në 12 ECTS. Në përfundim të saj, studentët hartojnë një raport të cilin e dorëzojnë dhe mbrojnë para komisionit. Evidenca 21, 39, 40			
Konkluzione	<i>UL ka procedura dhe marrëveshje për të mundësuar praktikrat profesionale të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në kete program studimi plotëson <i>kryesisht</i> kriteret ligjore të kualifikimit, pasi ka lektorë me titull Msc apo të cilët janë ende në proces doktorature.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2019-2020 dhe 2020-2021 ka respektivisht nga 1 staf akademik me titull <i>Msc</i>.</p> <p><i>Vlen të përmendet sugjerimi për të parë mundësinë për një përshtatje më e mire e profilit stafit akademik dhe lëndës që mbulohet në programin e studimit, si edhe udhëheqësit dhe temës së masterit punuar nga studentët.</i></p> <p>RVB tabela 6</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Tabela 4 në RVB pasqyron vetëm ngarkesën në orë mësimore, duke mos përfshirë orët për udhëheqjen e temave të diplomës. Sic përmendëm më lartë, nga E3 shtesë, GVJ evidenton se një pedagog udhëheq edhe 9 tema diplome vetëm në MshME, duke mos përfshirë mundësinë e angazhimit në ndonjë program tjetër. Pra 9x20 orë = 180 orë të paevidentuara në tabelën 4. Për rrjedhojë ka edhe pedagog me ngarkesë faktike mbi 400 orë në total.</p> <p><i>GVJ sugjeron uljen e ngarkesës mësimore, e cila mund të çënojë cilësinë e programit por edhe uljen e angazhimit në aktivitete kërkimore-shkencore.</i></p> <p>RVB, tabela 4 Udhezim nr. 29, dt. 10.09.2018, pika 12, c</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitave në institucion, pjesa më e madhe e stafit akademik PAE kanë mbi 5 vite të angazhuar në FE.</p> <p>RVB</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të hartuara në përputhje me bazën ligjore dhe të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e brendshme të UL.</p> <p>Përsa i përket përmbushjes së pjesës së fudit të këtij kriteri: përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, <i>GVJ konstatoi se ka raste të pedagogëve me profil juridik që mbulojnë lëndë të menaxhimit. Si rrjedhojë sugjeron të shikohet mundësia për një përshtatje më të mire të profilit të stafit akademik dhe lëndës që mbulohet në programin e studimit.</i></p> <p>Referuar njoftimeve në faqen web të institucionit, konstatohet se UL bën publike thirrjet për punësim të stafit akademik efektiv dhe me kontratë. <i>Sugjerohet që në këtë thirrje të publikohet edhe procedura si dhe metodologjia e vlerësimit nga komisioni ad hoc.</i></p> <p>Evidenca 95, 98</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UL ka hartuar rregullore të vecanta të cilat përcaktojnë qartë rolin dhe kopetencat e personelit ndihmës akademik.</p> <p>Evidencat 4, 15, 27, 53, 68</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>UL mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit përgjegjës për organizimin e programit të studimit MShME, personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe të personelit ndihmës akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Nëpërmjet konsultimit të dosjeve të stafit të përzgjedhur në mënyrë rastësore u konstatua se dokumentacioni i mbledhur dhe ruajtur nga zyra e Burimeve Njerëzore konsiston në: CV, Kontratë, Librezë pune, Fotokopje ID, Diploma dhe listë notash të noterizuara, Certifikatë të gjuhës së huaj, etj. <i>CV, Raport Mjeko-Ligjor dhe Librezë shëndetësore janë kryesisht të pa përditësuara.</i></p> <p><i>GVJ konstatoi se kontratat kanë këto parregullsi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>ka kontrata pune me afat të pacaktuar për stafin akademik Msc,</i> - <i>nuk përcaktojnë ngarkesën mësimore,</i> - <i>për stafin PAK nuk ka leje angazhimi nga qendra e tyre e punës</i>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të</p>	<p>Gjatë vizitave në institucion, GVJ iu referua se praktika mësimore koordinohet nga një staf akademik, së bashku me Zyrën e Karrierës Praktika profesionale, dhe në bashkëpunim me institucionet ku UL ka marrëveshje bashkëpunimi.</p>

duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Përsa i përket punimit të diplomes, gjatë takimeve në institucion u referua se ato mbulohen kryesisht me PAE (3-5 diploma secili) por ka edhe PAK. Sic përmendet edhe më lart, GVJ evidenton (E3 shtesë), se një pedagog udhëheq edhe 9 tema diplome, ndër të cilat edhe mospërputhje të profilit të udhëheqësit dhe temës së diplomës. E3 shtesë, Evidencat 23, 38			
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	UL përmbush këtë kriter duke vënë në dispozicion një kordinator për ndjekjen e praktikave deri në mbrojtjen e tyre para një komisioni. RVB, Evidenca 39			
Konkluzione	<i>GVJ rekomandon te mbahet parasysh mos përfshirja e stafit akademik me titull Msc ne programin e studimit, si edhe rregullimi i kontratave te punes, ne zbatim te legjislacionit ne fuqi. Po ashtu sugjeron per te parë mundësinë për një përshtatje më e mire e profilit stafit akademik dhe lëndës që mbulohet në programin e studimit, si edhe udhëheqësit dhe temës së masterit te punuar nga studentët. Gjithashtu, GVJ sugjeron uljen e ngarkeses mesimore, e cila mund të çënojë cilësinë e programit por edhe uljen e angazhimit në aktivitete kërkimore-shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar evidencave si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se UL disponon laborator informatike, auditorë për leksione dhe seminare, bibliotekë, ambjente për persoelin akademik dhe administrativ, mjedise këto të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, si dhe në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit MShME. Tabela 16, RVB

<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga informacioni i vënë në dispozicion dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni disponon salla për seminare dhe leksione të pajisura me projektorë dhe tabela. Gjatë pandemisë mësimi u zhvillua online zhvillohet online, dhe institucioni ka marrë masat e duhura duke vënë në dispozicion platformat online.</p> <p>UL ka 5 laboratore me 120 pc me parametra bashkëkohore.</p> <p>Ekspertët konkludojnë se këto mjedise janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e mësimit të programit MshME, por ndërkohë, rezulton që <i>laboratori i teknologjisë nuk është i pajisur plotësisht me programe softëarike specifikiisht të lidhura me këtë MSh ME, sidomos të nevojshme për përpunimin dhe analizimin e të dhënave të mbledhura gjatë kërkimit shkencor cilësor.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që UL të pajisë laboratorin e teknologjisë me programe softëarike, si psh. Perverc SPSS, edhe programe si EVieës si edhe NVivo ose Atlas.ti, etj. të nevojshme për përpunimin dhe analizimin e të dhënave gjatë kërkimit shkencor sasior dhe cilësor si të stafit akademik ashtu dhe të studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Evidenca 87</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Evidenca 39, 87</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>UL bashkëpunon me institucione publike dhe private të tjera për zhvillimin e praktikave profesionale si dhe veprimtarive të tjera praktike.</p> <p>Evidenca 39, 87</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ sugjeron që UL të pajisë laboratorin e teknologjisë me programe softwarike, si psh. Perverc SPSS, edhe programe si EVieës si edhe NVivo</i></p>




	ose Atlas.ti, etj. të nevojshme për përpunimin dhe analizimin e të dhënave gjatë kërkimit shkencor sasior dhe cilësor si të stafit akademik ashtu dhe të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura baze e referuar ne syllabuse dhe ajo fizike që disponohet në bibliotekë, tejkalon 5 vjecarin e fundit. Gjatë takimeve në institucion, GVJ mësoi se stafi akademik ve në dispozicion të studentëve kopje elektronike të përditësuara. Evidenca E2 shtesë, e dërguar pas vizites ne institucion, nuk eshte e mjaftueshme për të evidentuar përditësimin e kopjeve elektronike, pasi pasqyron vetem kopertinen e disa prej titujve qe presupozohet ti vihet studenteve ne dispozicion ne Moodle. E 2 shtese_Literatura online Moodle MSHME.pdf E2. Literatura
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	Gjatë takimeve në institucion u referua se stafi akademik rishikon syllabuset dhe literaturën e referuar në to, por për këtë nuk ka evidenca. <i>GVJ sugjeron që njësia përgjegjëse të planifikojë një plan-buxhet me zë të vecantë për përditësimin e literaturës dhe të raportojë këto përditësimet edhe në raportet që harton.</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve të programit MShME bibliotekën mësimore dhe ju garanton atyre mundësi të barabartë të shfrytëzimit. Biblioteka u vizitua gjatë vizitës në institucion.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e	Gjatë vizitës në institucion si dhe referuar dokumentacionit të depozituar nga IAL, GVJ konstaton se biblioteka është e pajisur në literaturë si tekste mësimore bazë dhe literaturë ndihmëse në fushën ekonomike (Ref. RVB). Por GVJ konstaton se kjo literaturë është përtej 5-vjeçarit të fundit në disa fusha. <i>GVJ rekomandon që institucioni të pasurojë literaturën e bibliotekës me një gamë më të gjerë botimesh bashkëkohore librash në gjuhën shqipe dhe angleze, si libra, revista shkencore e periodikë për programin e studimit MShME.</i>

specifikës së programit të studimit.	
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Referuar RVB studentet kanë mundësi të shfrytëzojnë pa pagesë bibliotekën online.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Referuar RVB, biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje teknike. <i>GVJ sugjeron që përvec programeve kompjuterike bazë të instalohen edhe softëare për përpunimin e të dhënave sasimore dhe cilësore për tu ardhur në ndihmë studentëve në realizimin e temave të masterit.</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka në UL qëndron e hapur gjatë periudhës e hene - e Premte në orarin 8-20.00 dhe gjatë sezonit të provimeve me orar të zgjatur. Kapaciteti I sallës së bibliotekës është 20 persona, e cila duket të jetë e relativisht e vogël në përgjigje të numrit të studentëve. Evidenca 53, 86
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Sic evidentohet edhe më sipër, Evidenca 50 Lista e literatures ne funksion te programit pasqyron literaturë përte 5-vjecarit të fundit. Titulli më i ri është botim i vitit 2014. Megjithatë institucioni mundohet ta plotësojë me titull elektronik më të përditësuar.
Konkluzione	<i>GVJ rekomandon që institucioni të hartojë plan buxhet zë të vecantë dhe të pasurojë literaturën e bibliotekës me një gamë më të gjerë botimesh të përditësuar librash në gjuhën shqipe dhe angleze, si libra, revista shkencore e periodikë për programin e studimit MShME. Gjithashtu, të</i>

	<i>shikohet mundësia e zgjerimit të kapacitetit të bibliotekës/sallës së studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstaton bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion dhe vizitës në institucion, se informacioni lidhur me studentët e programit të studimit MShME mbahet nga sekretaria mësimore me anë të regjistrave manualë. Gjithashtu, është vënë në dispozicion edhe sistemi online Pitagora, ku çdo student ka kredencialet e tij për të marrë informacion të personalizuar lidhur me notat apo lëndët që duhet të frekuentojë. Ndërkohë të dhënat dhe dokumentacioni i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, mbahet në dosje nga Zyra e Burimeve Njerëzore.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimet me stafin akademik dhe studentët gjatë vizitës në institucion, ekspertët konstatuan se UL mundëson komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit personelit akademik dhe studentëve nëpërmjet emailëve zyrtarë, platformës elektronike MOODLE-LMS, Microsoft Office (sharepoint).
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Evidenca 47, 76, 84, 103, 104
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson	

raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstaton se informacionet lidhur me programin e studimit MshME, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në gjuhën shqipe, dhe pjesa më e madhe e tyre edhe në gjuhën angleze, kjo e fundit ne process zhvillimi nga IT.
Konkluzione	<i>Ekspertët konstatuan se UL mundëson komunikimin interaktiv, nëpërmjet një sistemi të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të stafit akademik, administrativ dhe studentëve.</i>
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet
	Përmbushet pjesërisht
	Përmbushet kryesisht
	Përmbushet plotësisht
	X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Referuar rregullores së UL dhe evidencës 42, si edhe RVB, ekspertët mendojnë se AL harton një raport financiar të kostove dhe planin për mbështetjen financiare për mbarëvajtjen institucionale. Ky plan financimi institucional përmban kostot e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën, si dhe detyrime të tjera financiare.

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion</p>	<p>Megjithatë, <i>GVJ gjykon të nevojshme që institucioni të hartojë raporte financiare si dhe planin për mbështetjen financiare të detajuar për të garantuar mbarëvajtjen e programit të studimit MShME referuar kohështrijres të këtij programi.</i></p> <p>Evidenca 4, 42</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar informacionit në RVB raportimi financiar i UL përmban një pasqyrë financiare të të ardhurave dhe institucioni i nënshtrohet kontrollit të auditimit.</p> <p><i>Bazuar në këtë kriter, GVJ rekomandon që institucioni, përtej dokumentimit të gjendjes financiare, të vlerësojë edhe efektivitetin financiar të programit MShME, si dhe mundësitë e gjenerimit të të ardhurave nga burime të tjera për të rritur qëndrueshmërinë e tij financiare.</i></p> <p>Evidencat 91, 92</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Sipas RVB dhe takimeve në institucion, raportimet financiare realizohen vetëm në nivel institucional.</p> <p>Evidenca 42</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në pasqyrat financiare, duket se institucioni garanton qëndrueshmëri financiare, duke pasur parasysh numrin e studentëve dhe të ardhurat në rritje.</p> <p>Nuk ka evidence për ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p> <p><i>GVJ sugjeron të diversifikohen burimet e financimit duke eksploruar mundësi të tjera të ardhurash, p.sh projekte kombëtare/ndërkombëtare, përvec konsulencave dhe tarifave të edukimit. Kjo do të shërbente si garanci për rritjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të programit të studimit.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ sugjeron të diversifikohen burimet e financimit duke eksploruar mundësi të tjera të ardhurash, p.sh projekte kombëtare/ndërkombëtare,</i></p>




	<i>përvec konsulencave dhe tarifave të edukimit. Kjo do të shërbente si garanci për rritjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Statuti UL (Evidenca 3) dhe Rregullorja e programit MshME (Evidenca 10), përcaktojnë procedurat e hyrjes dhe daljes së studentëve në program, si ata mund të regjistrohen, kriteret që duhet të përmbushin, kërkesat mësimore dhe përfundimin me diplomë. Sekretaria mësimore mbikëqyr këtë proces. Evidenca 3, 10, 110
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Rregullorja e programit, fakultetit dhe institucionit, në zbatim të ligjit të arsimit të lartë, janë një bazë e mirë për të garantuar barazinë e të drejtave të njëjta. Nga vlerësimi nuk lihet të dyshohet për diskriminim ndaj studentëve. Evidenca 3, 10
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	UL zbaton udhëzimet e MASR lidhur me kriteret e pranimit për ciklin e dytë të studimeve. Bazuar në informacionin e mbledhur gjatë takimeve në institucion, nuk ka kritere të veçanta për pranimin e studentëve që vijnë nga një profil tjetër studimi bachelor, si psh infermieri etj. <i>Megjithatë, E41, neni 5, pika 1 përcakton qarte se: "Në programet e Ciklit të Dytë të Studimeve (Master i Shkencave) të ofruara nga Fakulteti Ekonomik pranë Universitetit "Luarasi", kanë të drejtë të regjistrohen studentët që plotësojnë kushtet e mëposhtëme: Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor, në Ekonomik me programe të ngjashme me fushën e Ekonomikut,..... Kanë të drejtën e pranimit vetëm aplikantët nga fushat e mësipërme, njohuritë formuese të të cilëve konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program për jo më pak se 2/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve të tyre (jo më pak se 80 kredite).</i> <i>GVJ rekomandon zbatimin e kësaj politike të vendosur nga vetë institucioni dhe sugjeron ofrimin e kurseve bazë të detyrueshme të cilat të përgatisin studentët me profil të ndryshëm nga ai i MshME, me qëllim përgatitjen e tyre për lëndë të avancuara të programit, por edhe ruajtjen e nivelit të kursit për ata student që vijnë nga edukim bachelor në menaxhim.</i> Evidenca 3, 41, 44
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së	Nga takimi me Zyrën e Alumnit dhe Karrierës u konfirmua që institucioni përdorë ditet e karrierës për të bërë publike procedurat dhe

studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<p>kriteret e pranimit. Këto kritere si edhe kriteret e përparimit të tyre, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e UL, të Fakultetit, të Departamentit dhe të programit të studimit.</p> <p><i>GVJ sugjeron që politikat dhe procedurat e mësipërme të bëhen publike përmes web-faqes së institucionit.</i></p>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<p>Përpara cdo fillimi viti akademik, sipas informacionit që GVJ mbledhi gjatë vizitës në institucion, UL njeh palët e interesuara me programin e studimit që ofron dhe kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për çdo program. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet ditëve të karrierës.</p>			
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<p>Vizita në institucion dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion konfirmojnë që UL miraton në fillim të vitit akademik kriteret për pranimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe rregulloret përkatëse.</p> <p>Evidenca 3, 41, 44</p>			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	<p>Referuar RVB, UL harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p> <p>Evidenca 10, 41</p>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>Sipas RVB, UL harton politika të bursave për student në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p>Evidenca 67</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ sugjeron ofrimin e kurseve bazë të detyrueshme të cilat të përgatisin studentët me profil të ndryshëm nga ai i MshME, me qëllim përgatitjen e tyre për lëndë të avancuara të programit, por edhe ruajtjen e nivelit të kursit për ata student që vijnë nga edukim bachelor në menaxhim.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.2				
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Rregullorja e programit të studimit përcakton procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin. Këto informacione jepen gjate javes se pare te orientimit të studentëve dhe u bëhen të njohura edhe nga takimet qe kanë studentët me përgjegjësen e departamentit e cili shërben edhe si koordinatorë programit.			
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Rregullorja e programit të studimit përcakton procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve. Ky informacion pasqyrohet edhe në fletëpalosjet informuese të UL. U panë dhe u verifikuan disa dosje studentësh të regjistruar në sekretari. Evidenca 10, 67			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Stafi akademi u bën të ditur studentëve që orën e parë të mësimit programin e lëndës si edhe mënyrën e vlerësimit të tyre. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuar në rregulloret e njësisë kryesore dhe asaj bazë, si edhe në programet e cdo lënde. Evidenca 10, 21			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e programit MshME, dhe rregulloren e diplomimit. Institucioni ka hartuar edhe një udhëzues mbi punimin e diplomës që u bëhet i njohur studentëve nga takimet me përgjegjësin e departamentit (njëkohësisht edhe koordinator i programit) dhe pedagogët udhëheqës të tyre. Evidenca 10, 37			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në fillim të çdo viti akademik institucioni organizon takime të hapura me të interesuarit për ti informuar mbi programet e studimit që ofron ky institucion. Gjithashtu UL është aktiv në rrjetet sociale, News 24 dhe webfaqen e UL, përgatit fletëpalosje dhe postera për të bërë publike programet e studimit të ofruara prej tij.			
Konkluzione	<i>UL informon vazhdimisht studentët mbi përparimin akademik, njohjen dhe vlerësimin e dijeve të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3				
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjate takimeve ne institucion, rezultoi se informimi i studetëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu një informacion i përgjithshëm shfaqet në ëebfaqen e UL.			
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që studentët që ditën e parë njihen me rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit dhe në orën e parë të mësimi u bëhet i njohur programi i lëndës. Evidenca 21			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni nëpërmjet Zyrës së Studenteve dhe Keshillimit te Karrierës informon si studentët potencialë edhe ata që rregjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi. Evidenca 111			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambientet e Fakultetit të Biznesit, dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e universitetit lidhur me mjediset qe do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Gjatë takimeve me stafin akademik grupin e punës por edhe studentet, na u referua se çdo pedagog ofron komunikimin me e-mail me studentët, Moodle, Microsoft-Teams të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike.			
Konkluzione	<i>Ekspertët konstatuan se studentët janë të mirëinformuar mbi programin e studimit si edhe mundësitë e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Sekretaria mban statistika mbi numrin e të diplomuarve për programin e studimit, gjë e cila u konfirmua edhe nga vizita në sekretarinë mësimore të UL.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sipas Rregullores së Sekretarisë Mësimore institucioni mban të dhëna vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit. Një gjë e tillë u evidentua nga takimi me zyrën e sekretarisë mësimore dhe shqyrtimit të regjistrave të studentëve. Nr i studentëve është si vijon për vitet akademike: 2019-2020: 33 studentë 2020-2021:52 studentë, 2 janë ende të pa matrikular 2021-2022: 45 studentë 2022-2023: 50 studentë Vihet re një qendrueshmëri e numrit të studentëve të këtij programi.
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Gjithashtu, UL përdor sistemin elektronik Pitagora. Evidenca 68, 78
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njëjësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Sipas Rregullores së Sekretarisë Mësimore institucioni duhet t'i zotërojë këto të dhëna. Këto të dhëna ruhen në mënyrë rigorozë nga sekretaria mësimore. Ato u shqyrtuan gjatë këtij procesi vlerësimi. Sekretaria mësimore dhe institucioni raporton këto të dhëna edhe në MASR. Evidenca 3, 68
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike,	Në fund të çdo viti akademik, institucioni bën një analizë mbi profilit dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të studentëve.

periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti AB bashkepunon me zyren alumni shkallën e cilësisë së punësimit të tyre. Evidenca 46, 48			
Konkluzione	<i>UL mbledh, administron, përditëson dhe ruan të gjitha të dhënat e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Rregullorja e institucionit (neni 9: Komisionet e përhershme në nivel institucioni përbëhen nga jo më pak se katër anëtar, prej të cilëve një është student, i propozuar nga Këshilli Studentor), dhe takimet me studentet, konkludojnë se Kryetari i Këshillit Studentor merr pjesë në Senatin Akademik, NJSB, Këshillin e Etikës (neni 12), dhe studentët kanë përfaqësues në mbledhjet dhe grupin e punës GVB.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<i>Gjate shkrimit të RVB do të ishte mirë të jepej informacion specifik duke cituar nenet përkatëse të rregulloreve, sipas kriterëve ku aplikohen.</i> Evidenca 4, 55, 116
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të	Zyra e NJSBC merret me analizimin e opinioneve të studenteve të mbledhura nepermjet pyetesorëve. Deri tani nuk është bërë ndonjë rishikim kurrikule, por në takime u fol edhe për përfshirjen të alumni në të ardhmen në këtë process. Evidenca 114

përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.									
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Rregullorja e UL (neni 75), parashikon që studentët kanë të drejtë të shikojnë fletët e vlerësuar të provimeve si dhe të kërkojnë rishikim të vlerësimeve. Sipas RVB, studentët kanë të drejtë të kërkojnë ngritjen e komisionit pranë departamentit. Nderkohe, bazuar në rregulloren e UL, studentët kanë të drejtë të paraqesin brenda tre ditëve nga marrja dijëni e vlerësimit, ankesë me shkrim tek Dekani i fakultetit përkatës. Ankimimi i dërgohet Departamentit përkatës dhe përgjegjësi i I tij ngre një komision ad-hoc vlerësimi, jo më vonë se 5 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim. <i>GVJ rekomandon që ky proces të përshkruhet me detaje në RVB duke përmendur nenet e rregulloreve përkatëse.</i> Evidenca 4, 114, 132								
Konkluzione	<i>Programi i studimit ka përfaqësuesit e tij në organet vendimmarrëse e këshilluese.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Institucioni parashikon në rregulloret e tij informimin e studentëve dhe ju jep të drejtën e organizimit nëpërmjet Këshillit Studentor të parashikuar në rregulloren e UL. Në rregulloren e MshME studentët kanë të drejtë të informohen mbi rezultatet dhe t'i ankojnë ato brenda procedurave të parashikuara. Ndërkohë institucioni mban komunikim të mirë dhe të vazhdueshëm në lidhje me mësimdhënien dhe mundësi të tjera nëpërmjet zyrës së këshillimit të karrierës dhe studentit. Evidenca 4, 56
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në UL zyra e studentit dhe këshillimit të karrierës asiston studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe këshillon lidhur me çështjet mësimore, praktikat dhe programin e studimit. Evidenca 4, 56

<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>				
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Alumni, pjese e zyrës së këshillimit të Karrierës është përgjegjëse për ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të studentëve pas diplomimit.</p> <p><i>Do ishte me vlerë që krahas RVB të ishte paraqitur një evidencë se si përdoren këto të dhëna nga autoritetet drejtuese, si dhe nëse kryhen organizime për të mbajtur të angazhuar Alumni nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme.</i></p> <p>Evidenca 49, 56, 112</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UL ka procedura dhe njësi të posaçme nëpërmjet të cilave orienton, këshillon dhe bën menaxhimin e ankimeve e problematikave të studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>
----------------------------------------------------------------	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---------------------------------------




VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti "Luarasi" ka zhvilluar seminare kualifikuese në nivel institucional për njohjen, zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mesimdhënies. UL ka hartuar Udhëzuesin strategjik të metodave inovative të mësimdhënies për zhvillimin e aftësive të stafit akademik për tu përshtatur me ndryshimet në botën akademike. GVJ konstaton se trajnimet e personelit akademik duhet të nxiten dhe intensifikohen duke u orientuar në nxitjen e përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies për stafin akademik. Nga vizita dhe dokumentacioni ekzistson vetëm një trajnim në vitin 2019 (Evidenca 80).</p> <p><i>Evidenca 90. Udhëzues Melodat Inovalive të Mesimdhënies</i> <i>Evidenca 80. Modul trajnimi "Learning assessment and student motivation"</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ konsttaon se Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në Bashkëpunim me Dekanatin e Fakultetit Ekonomik kanë hartuar dhe zbatojnë mekanizma, procedura për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmësakademik. GVJ konstaton se analiza e vlerësimit është në nivel institucional (Evidenca 126) duke mos patur një analizë specifike për departamentin AB në funksion të përmirësimit të programit të studimit MShME.</p> <p><i>Evidenca 120. Formulari i Vleresimit te Pedagogut nga Eprori</i> <i>Evidenca 126. Analiza e vleresimit te cilesise se mesimdhënies ne shkollat e larta mbi bazen e metodave statistikore</i> <i>Evidcnca 118. Format raporti vleresimi Pedagogu</i> <i>Evidenca 119. Format-raporti me komentet e vleresimit të Pedagogut</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ kosntaton se Universiteti "Luarasi" garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve. Gjithashtu, konstatohet se kjo përfshirje është e ulët pasi referuar Evidencës 118, formati vlerësimit përfshin vetëm V.A. 2018-2019 me përfshirjen e vetëm 4 studentëve nga 20 të mundshëm. GVJ konstaton se analizat duhet të jenë të shtrira në vite dhe specifiku për programin e studimit (MShME) me një kuorum më të lartë kampionit përfaqësues (studentët) me qëllim identifikimin e cilësisë së cilësisë së mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve.</p> <p><i>Evidenca 118. Format raporti vleresimi Pedagogu</i> <i>Evidenca 119. Format raporti me komente vleresimi Pedagogu</i> <i>Evidence 132. Rregullore e Ankimimit të Studenteve</i></p>

	<i>Evidenca 133. Formular Vleresimi i Studenteve per pedagogun dhe lenden</i>			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ konstaton se rezultatet e monitorimit të stafit akademik për sigurimin e cilësisë dhe mësimdhënies i bëhen të ditura anëtarit të stafit që monitorohet nga ekipi monitorues, menjëherë pas monitorimit në auditor, duke theksuar anët positive dhe aspektet që duhet të përmiresohen në të ardhmen. <i>Evidenca 118. Format raporti vleresimi Pedagogu</i> <i>Evidenca 119. Format raporti me komente vleresimi Pedagogu</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ konstaton se institucioni ka metododa të vëzhgimeve të paparlajmëruara (Evidenca 124) ku monitoron funksionimin e procesit mësimor. GVJ sugjeron se institucioni duhet të promovojë më tej shembuj të praktikave të mira për nxitjen e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. <i>Evidenca 124. Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar te cilesise ne metodat e mesimdhënies</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka politika të institucionalizuara për procedurat dhe njësitë përgjegjëse për promovimin dhe garantimin e cilësisë por GVJ konstaton se: trajnimet e personelit akademik duhet të nxiten dhe intesifikohen duke u orientuar në nxitjen e përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies për stafin akademik; analizat e vlerësimit të NJSBC duhet të jenë më specifike dhe detajuara në nivel programesh me një kuorum më të lartë të kampionit përfaqësues (studentët) me qëllim identifikimin e cilësisë së cilësisë së mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në Universitetin "Luarasi" ka strukturë të posaçme, Njesia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. Gjithashtu ka procedura, manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë në Universitetin "Luarasi" është konceptuar dhe funksionon në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, ku NJBSC ka vepruar si një njësi organizative e përhershme me përbërje sipas Vendimit të Senatit Akademik të Kolegjit Universitar "Luarasi" Nr. 12/4, date 23.12.2016. <i>Evidenca 121. Manuali NJSBC</i>

	<p><i>Evidenca 123. Vendim mbi ngritjen e NJSBC</i> <i>Evidenca 125. Politikat e Cilesise ne UL</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UL në përbërje të strukturës së tij organizative ka të ngritur, dhe mban në funksion zyrën e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. NJSBC me aktivitetin e saj synon në mënyrë të vazhdueshme përmirësimin e cilësisë. Në këtë zyrë aktivizohen, përveç, stafit akademik edhe studentët dhe bashkëpunëtorë të jashtëm. Funksionimi i NJSBC garantohej nga statuti i Universitetit "Luarasi" (Neni 74) dhe Manuali i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. GVJ konstaton se duke patur parasysh madhësinë e Institucionit në njësi kryesore dhe nr e programeve që ofron, NJSBC duhet të rrisë përbërjen e saj me burimet e nevojshme njerëzore, në mënyrë që të jetë në gjendje të zbatojë të gjitha objektivat dhe funksionet e saj. Kjo nevojë u konstatua dhe gjatë takimit me drejtuesit e NJSBC.</p> <p><i>Evidenca 3. Statuti i UL</i> <i>Evidenca 121. Manuali NJSBC</i> <i>Evidenca 122. Strategjia e NJSBC</i> <i>Evidenca 123. Vendim mbi ngritjen e NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UL për sigurimin e cilësisë mbështetet në përpilimin e Raportit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Ai përdor instrumentat duke u mbështetur në standardet dhe kriteret e legjislationit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Të gjitha vetëvlerësimet e brendshme dhe vlerësimet e jashtme në Universiteti "Luarasi" janë bërë dhe bëhen duke u mbështetur në dokumenta, procedura, anketime, si edhe takime me palët e interesuara. GVJ konstaton se NJSBC nuk është mbështetur më tej në vlerësime out-sourcing (krahasuese) nga subjekte të pavarura të specializuara me qëllim promovimin apo përmirësimin e cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 121. Manuali NJSBC</i> <i>Evidenca 122. Strategjia e NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Në Universitetin "Luarasi" përdoren Formularë vlerësimi për ecurinë e programeve të studimit dhe aktiviteteve të tjera akademike. GVJ konstaton se mungon një raport analitik semestral/vjetor me rezultatet dhe gjetjet e NJSBC për pasqyrimin e gjendjes reale të cilësisë në funksion të programit të studimit MShME.</p> <p><i>Evidenca 114. Format i pyetesorit per mesimin online</i> <i>Evidenca 118. Analiza e pyetesorit të studenteve</i> <i>Evidenca 133. Formular Vleresimi i Studenteve per pedagogun dhe lenden</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se institucioni ka krijuar procedura të dedikuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Informacioni i siguruar nga këto struktura duhet t'i përcillet drejtuesëve për të përmirësuar politikat e brendshme dhe orientuar burimet mbështetëse. GVJ sugjeron që NJSBC duhet të rrisë</i></p>

	përbërjen e saj me burimet e nevojshme njerëzore, në mënyrë që të jetë në gjendje të zbatojë të gjitha objektivat dhe funksionet e saj. GVJ gjithashtu vëren se NJSBC duhet të përfshihet më shumë në monitorime që garantojnë cilësinë e formatimit dhe përditësimin të syllabuseve sipas rekomandimit të përmendur (Standardi II.3/Kriteri 4).		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>NJBSC-ja vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të gjithë programet e studimit. GVJ konstaton se mungon një raport analitik semestral/vjetor me rezultatet dhe gjetjet e NJSBC për pasqyrimin e gjendjes reale të cilësisë në funksion të programit të studimit MShME. GVJ konstaton se analizat duhet të jenë të shpura në vite dhe specifiku për programin e studimit (MShME) me një kuorum më të lartë kampionit përfaqësues (studentët) me qëllim identifikimin e cilësisë së cilësisë së mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve. Evidenca 131 i referohet zbatimit në praktikë të syllabuseve për një program tjetër studimi prandaj NJSBC duhet të përfshihet më shumë në monitorime që garantojnë cilësinë e formatimit dhe përditësimin të syllabuseve të programit MshME sipas rekomandimit të përmendur (Standardi II.3/ Kriteri 4).</p> <p><i>Evidenca 124. Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësisë në melodat e mesimdhënies</i></p> <p><i>Evidenca 131. Si zbalohen në praktike syllabuset e lendeve</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Si më sipër konstatohet se mungon raporti i NJBSC ku paraqiten rezultatet e vlerësimit, praktikat dhe arritjet më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p> <p><i>(në Evidencën 132 – paraqitet Rregullorja e Ankimimit dhe jo Raporti NJSBC sipas emërimit).</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Universiteti "Luarasi", në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. GVJ sugjeron se NJSBC duhet të përfshihet më shumë në monitorime që garantojnë cilësinë e formatimit dhe përditësimit të syllabuseve të programit MshME sipas rekomandimit të përmendur (Standardi II.3/Kriteri 4).</p> <p><i>Evidenca 133. Formular Vleresirni i Studenteve per pedagogun dhe lenden</i></p> <p><i>Evidenca 118. Format raporti vleresimi Pedagogu</i></p> <p><i>Evidenca 119. Format raporti me komente vleresimi Pedagogu</i></p> <p><i>Evidenca 124. Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësisë në metodat e mesimdhënies</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Universiteti "Luarasi", nëpërmjet NJBSC, përdor metoda dhe instrumente matëse të tërthorta në formën e sondazheve për vlerësimin e mësimdhënies, të lëndëve/moduleve si dhe të të nxenit. NJBSC i përpunon të dhënat e grumbulluara, (Evidenca 115) por sipas kësaj evidence analiza i referohet vetëm studentëve të viteve të fundit për të dy ciklet e studimit dhe nuk ka një vit të përcaktuar se kur është bërë si analizë. NJSBC duhet të bëjë analiza pyetësorësh cdo vit akademik/ në cdo semestër për cdo vit studimi për të patur një kuadër më të qartë lidhur me cilësinë e perceptuar nga studentët dhe që më pas ia bën të ditura drejtuesve të departamenteve, të fakulteteve dhe të institucionit.</p> <p><i>Evidenca 118. Format raporti vleresimi Pedagogu</i></p> <p><i>Evidenca 115. Analiza e pyetesorit te studenteve</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se NJSBC duhet të monitorojë në mënyre periodike (cdo fundsemestër/vit akademik) cilësinë dhe t'i përdorë këto të dhëna për të adresuar problematikat e identifikuar dhe për të replikuar praktikatat e mira. GVJ sugjeron se NJSBC duhet të përfshihet më shumë në monitorime që garantojnë cilësinë e formatimit dhe përditësimit të syllabuseve të programit MshME.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Funksionimi i njësisë garantohej nga statuti i Universitetit "Luarasi" (Neni 74), Manuali i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të hartuar në përputhje me Kodin e Cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 121. Manuali NJSBC</i> <i>Evidenca 122. Strategjia e NJSBC</i> <i>Evidenca 62. Urdher për ngritjen e GVB</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në nivel institucional përgjegjësit për cilësinë janë, Senati akademik, Rektori, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, Grupet e Vlerësimit të Brendshëm, Dekani, GVB në cdo fakultet si dhe studentët. Të gjithë përgjegjësit kanë detyra të qarta për të siguruar cilësinë si dhe të marrin pjesë në menyrë aktive në zhvillimin e modeleve vlerësuese si dhe në rishikimin e tyre.</p> <p><i>Evidenca 121. Manuali NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së cdo programi të studimit përfshihet njësia bazë (Departamenti përkatës) dhe kryesore (dekanati Fakultetit Ekonomik), që është përgjegjëse për programin e studimit, anëtarë të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentë të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi</p>	<p>Struktura e NJSBC përbehet nga pesë antarë të zgjedhur sipas Statutit neni 73 pika I, nga të cilët 3 janë personel akademik me kohë të plote, një ekspert i jashtëm si dhe një student i përzgjedhur nga Këshilli i Studentëve të institucionit.</p> <p>Perzgjedhja e personave kryhet në integritet të plotë dhe transparent.</p> <p><i>Evidenca 3. Statuti i UL</i> <i>Evidenca 121. Manuali NJSBC</i></p>

apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<i>Evidenca 123. Vendimi mbi ngritjen e NJSBC</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në vazhdimësi edhe në akreditimet e tjera të programeve mësimore, pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, janë përfshirë edhe pedagogë apo bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit. <i>Evidenca 123. Vendimi mbi ngritjen e NJSBC</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se Institucioni përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton se NJSBC ka një strategji ku bazon politikat e saj lidhur me vetëvlerësimin e brendshëm të cilësisë (Evidenca 122), por nuk ka një plan veprimi të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që do t'i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatesë. (Evidenca 108 – paraqet kalendarin akademik të programeve Master). <i>Evidenca 122. Strategjia e NJSBC</i> <i>Evidenca 108. Kalendari Akademik</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Duke marrë në konsideratë faktin se raportet e NJSBC-se përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, ato bëhen pjese e diskutimeve në ato grupe për të cilat raporti ka ndikim të drejtpërdrejtë. Në ato raste kur të dhënat vlerësohen se kanë një sensibilitet të lartë, raste trajtohen nga strukturat drejtuese me personin konkret në takime individuale.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë	GVJ konstaton se të dhënat e fituara nga instrumentet e vetëvlerësimeve periodike, pas përpunimit shfrytëzohen në mbështetje të procesit. Në kuadër të politikave të përmirësimit të cilësisë mund të përmendim:

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 66

përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Zhvillimin e trajnimeve të fokusuara në aspektet didaktikë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor; Inkurajimi dhe mbeshtetja e stafit akademik për pjesëmarrjen në aktivitete zhvilluese, brenda edhe jashtë vendit. <i>Evidenca 81. Moduli i trajnimit - How to write and to publish an academic paper</i> <i>Evidenca 82. Moduli i trajnimit - Mesimdhënia me ne qender studentin</i> <i>Evidenca 100. Metoda moderne mesimdhënieje</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni është përpjekur të sigurojë ndikimin e veprimtarive në kuadër të sigurimit të cilësisë.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë garantohet nga përfshirja e tyre në strukturat e garantimit të cilësisë. Informacioni për studentët shpërndahet nëpërmjet, rregulloreve, studentëve të përfshirë në struktura të ndryshme brenda institucionit (NJBSC, Senati Akademik, Zyra e Studentit, Java e orientimit-që zhvillohet në fillim të vitit akademik). <i>Evidenca 67. Guida UL</i> <i>Evidenca 02. Java e Orientimit</i> <i>Evidenca 109. Zyra e Studentit dhe Keshillitnit te Karrieres</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni zhvillon procese dhe veprimtari të cilat janë publike dhe në tërësi efikase për krijimi dhe institucionalizimin e një kulture cilësie dhe përmirësimi të vazhdueshëm të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Menaxhim Ekzekutiv” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Luarasi”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Mbështetja institucionale e studentëve dhe fryma positive e krijuar nga departamenti AB dhe drejtuesja e tij jep ndikim pozitiv në mbarëvajtjen e procesit mësimor, informimit dhe shprehjen e mendimit të lirë nga studentët.
2. Infrastruktura dhe vendndodhja e institucionit.
3. Përdorimi me sukses i platformës online gjatë pandemisë dhe në vijim mundëson vijueshmërinë e programit të studimit.

Pika të dobta:

1. Programi MshME ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2012 dhe gjatë gjithë kësaj periudhe më shumë se 10-vjecare nuk është bërë asnjë rishikim kurrikule. **(Standardi III.4)**
2. Profili i stafit akademik mund të kishte një përputhje më të mirë me lëndët e programit MshME dhe mbikqyrjen e temave të diplomave, kjo e evidentuar nëpërmjet diplomave të tyre dhe lëndëve që ata japin. **(Standardi III.5 dhe IV.1)**
3. Syllabuset e programit MshME (Evidenca 21) paraqesin mangësi në disa elementë kryesorë si: paraqitja e tipologjisë sipas gërmëzimit dhe në përputhje me Planin Mësimor të Miratuar; mungesa e titullarit të lëndës: mungesa e shpjegimit të cdo teme sipas javëve të shpërndarjes tematike shoqëruar me literaturën përkatëse të detajuar me faqe dhe mungesa e literaturës së detyrueshme e përditësuar me botime të 5 viteve të fundit. **(Standardi II.3; II.4; III.1)**
4. Përfshirje e ulët e personelit akademik dhe mungesë e përfshirjes së studentëve në aktivitete dhe botime shkencore. Referuar Tabelës 22 nuk ka përfshirje studentësh në tre vitet e fundit në projekte shkencore në rang departamenti/njësie apo me të tretët. **(Standardi II.6)**
5. Mungesa e kriterëve specifike në pranimin e studentëve që vijnë nga fusha të tjera studimi. **(Standardi V.1 kriteri 3)**
6. Numër i kufizuar dhe i papërditësuar i fondit fizik të bibliotekës, rekomandim ky i akreditimit të mëparshëm. **(Standardi VI.3)**
7. Mungesa e një plan-buxheti të detajuar me zërat specifik për mbështetjen e trajnimeve dhe kriteret e financimit për aktivitete kërkimore/shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik, si dhe mungesa e një procedure transparente për alokimin e fondeve për kërkimin shkencor. **(Standardi IV.3)**

Rekomandime:

1. Të rishikohet kurrikula e programit ku të shikohen mundësi të futjes së lëndëve të tjera më të vlefshme për menaxherë dhe administrim biznesi, si për shembull sisteme ERP (Enterprise Resource Planning) apo CRM.
2. Të merret parasysh mundësia e përputhjes së profilit akademik të stafit të angazhuar dhe lëndëve e temave të diplomës që ata mbulojnë.
3. Duhet të përmirësohen dhe standardizohen Syllabuset e programit MshME (vendosja e titullarit të lëndes, tipologjia, shpërndarja e temave me literaturën përkatëse me nr. Faqesh, përditësimi i literaturës detyruese) në përmbushje të kriterëve sipas VKM 41/2018 e ndryshuar. NJSBC duhet të përfshihet më shumë në monitorime që garantojnë cilësinë e formatimit dhe përditësimin të syllabuseve.
4. Të përditësohet me botime të pesë viteve të fundit dhe shtohet numri i kopjeve fizike në bibliotekë .
5. Institucioni të rrisë mbështetjen për stafin akademik dhe studentët për pjesëmarrje në projekte dhe kërkim shkencor ndërkombëtar si dhe për botime shkencore në revista prestigjioze ndërkombëtare me faktor impakti. Gjithashtu, rekomandohet të përcaktohen kriteret e financimit për aktivitete kërkimore/shkencore si dhe procedure transparente për alokimin e fondeve për kërkimin shkencor.
6. Të zbatohen me kujdes rregulloret e institucionit (*E41, neni 5, pika 1*) mbi kriteret specifike në pranimin e studentëve që vijnë nga fusha të tjera studimi nga ato ekonomike, dhe institucioni ti bëjë ato të aksesueshme për studentët nëpërmjet Web-faqes zyrtare.
7. NJSBC duhet të rrisë përbërjen e saj me burimet e nevojshme njerëzore, në mënyrë që të jetë në gjendje të zbatojë të gjitha objektivat dhe funksionet e saj. NJSBC të integrojë edhe raportet vjetore departamentale dhe për program studimi, në raportin e saj vjetor. Analizat e vlerësimit të NJSBC duhet të jenë më specifike dhe detajuara në nivel programesh (MShME) me një kuorum më të lartë të kampionit përfaqësues (studentët) me qëllim identifikimin e cilësisë së cilësisë së mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve.


Conclusions of the Evaluation of the Second Cycle Study Program Master of Science "Executive Management" (MsEM) study program offered by the Higher Education Institution "Luarasi"

Strengths and Affirmations:

1. The institutional support of students and the positive spirit created by the BA department and its leader gives a positive impact on the progress of the learning process, information and the expression of free opinions by students.
2. Infrastructure and location of the institution.
3. The successful use of the online platform during the pandemic and beyond enables the continuity of the study program.

Weak points:

1. The MsEM program started its activity in 2012 and during this entire period of more than 10 years, no curriculum revision was made. **(Standard III.4)**
2. The profile of the academic staff could have a better match with the subjects taught in MsEM program and the supervision of the diploma thesis profile, this is evidenced through their diplomas theme and the subjects they teach. **(Standard III.5 dhe IV.1)**
3. The syllabuses of the MsEM program (Evidence 21) present deficiencies in some main elements such as: the presentation of the typology and in accordance with the Approved Curriculum; lack of subject title; lack of explanation of each topic according to thematic distribution weeks accompanied by relevant literature detailed with pages and lack of mandatory literature updated with publications of the last 5 years. **(Standard II.3; II.4; III.1)**
4. Low involvement of academic staff and lack of involvement of students in scientific activities and publications. Referring to Table 22, there is no involvement of students in scientific projects at the department/unit level or with third parties in the last three years. **(Standard II.6)**
5. Lack of specific criteria in the admission of students coming from other fields of study. **(Standard V.1 criteria 3)**
6. Limited and non-updated number of the library's physical fund, this recommendation was left also from the previous accreditation. **(Standard VI.3)**
7. Lack of a detailed budget plan with specific items for training support and funding criteria for research/scientific activities for the professional development of academic staff, as well as lack of a transparent procedure for the allocation of funds for scientific research. **(Standard IV.3)**



Recommendations:

1. To review the curriculum of the program where opportunities to introduce other more valuable subjects for managers and business administration, such as ERP (Enterprise Resource Planning) or CRM systems, should be considered.
2. To take into account the possibility of matching the academic profile of the academic staff and the subjects and topics of the diploma they cover.
3. The Syllabus of the MsEM program must be improved and standardized (setting the title of the subject, typology, distribution of topics with the relevant literature with no. of Pages, updating the mandatory literature) in fulfillment of the criteria according to VKM 41/2018 as amended. NJSBC should be more involved in monitoring to guarantee the quality of syllabus formatting and datings.
4. To update with publications of the last five years and increase the number of physical copies in the library.
5. The institution should increase its support for the academic staff and students towards participation in projects and international scientific research, as well as for scientific publications in prestigious international journals with an impact factor. Also, it is recommended to define the funding criteria for research/scientific activities as well as to establish a transparent procedure for the allocation of funds for scientific research.
6. To carefully implement the regulations of the institution (E41, article 5, point 1) on specific criteria for the admission of students coming from fields of study other than economic ones and publish them in the official website .
7. QA should increase its composition with the necessary human resources, so that to able to implement all its objectives and functions. QA to integrate the departmental and study program annual reports in its annual report. The QA assessment analyzes should be more specific and detailed at the program level (MsEM) with a higher quorum of the representative sample (students) in order to identify the quality of teaching and knowledge assessment.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	